



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 20/2022 regjistër (JR)
Datë 26.04.2022

Nr. 5 i vendimit
Datë 23.01.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 23.01.2025, ditën e enjte, ora 13:40, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejdini, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Shpëtim Reka, gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 512, datë 25.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës të Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes, Mimoza Tasi, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Shpëtim Reka [në vijim “subjekti i rivlerësimit”], për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në zbatim të nenit 179/b, pika 3, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) administroi raportet e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGJ”).

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të pasurisë, bazuar në nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë¹ së subjektit të rivlerësimit Shpëtim Reka, duke konkluduar se:

- i. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues të plotë për të ardhurat;
- ii. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- iv. nuk ka kryer deklarim të rremë;
- v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

2.2. DSIK-ja vuri në dispozicion të Komisionit Raportin për kontrollin e figurës², për subjektin e rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Shpëtim Reka.

3. KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit Shpëtim Reka, gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe pesë dokumente të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe i ka dërguar Komisionit, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

¹ Me shkresën nr. {***} prot., datë 04.02.2019, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë, të deklaratës së pasurisë së subjektit Shpëtim Reka, me funksion Gjyqtar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës”.

² Raporti nr. {***} prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar me vendimin nr. {***}, datë 26.05.2021, të KDZH-së.

³ Me shkresën nr. {***} prot., datë 13.10.2021, të KLGJ-së.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni me vendimin nr. 512, datë 25.02.2022, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Shpëtim Reka, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës”. [...]. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet për secilin prej kriterëve të rivlerësimit, si më poshtë:

4.1. Në lidhje me kriterin e pasurisë, subjekti u gjend me probleme në drejtim të verifikimit dhe kontrollit të kriterit të pasurisë, të cilat konsistojnë në:

- a) mungesën e burimeve të ligjshme për pasuritë në pronësi të tij dhe personave të lidhur;
- b) deklarin jo të saktë e në përputhje me ligjin;
- c) gjendjen në kushtet e konfliktit të interesit;
- d) kryerjen e veprimeve që nuk janë në përputhje me etikën dhe sjelljen e duhur për një gjyqtar.

Në këto kushte, Komisioni çmon se këto çështje mjaftojnë për të arritur në konkluzionin se subjekti nuk arriti një nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë dhe, sipas nenit 59, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, do të vlerësohen nga Komisioni në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit, që është kryer ndaj subjektit.

4.2. Në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit, z. Shpëtim Reka, nuk ka plotësuar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, duke mos deklaruar fakte dhe rrethana të ndodhura para dorëzimit të këtij formulari. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës dhe, sipas nenit 59, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, do të vlerësohet në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit, që është kryer ndaj tij.

4.3. Në lidhje me kriterin e aftësive profesionale, tërësia e veprimeve të subjektit të rivlerësimit tregojnë një raport të tillë të përkujdesjes së subjektit me zbatimin e ligjit, i cili është i papranueshëm për të pasur besimin e publikut. Rëndësia e sjelljes jashtëgjyqësore të gjyqtarit dhe ndikimi i saj në besimin e publikut te sistemi i drejtësisë është objekt rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri dhe pjesë e standardeve ndërkombëtare për sjelljen e gjyqtarëve. Në vlerësim të rrethanave të sipërcituara, trupi gjykues vlerëson se këto rrethana janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit, e cila duhet të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

5. Në përfundim, Komisioni konkludon se, në një analizë të përgjithshme të të gjitha konkluzioneve të arritura e të arsyetuara në vendim, subjekti dhe personat e lidhur me të, jo vetëm kanë disponuar e gëzuar pasuri, të cilat rezultojnë me problematika në drejtim të legjitimitetit të burimeve të tyre, por edhe ka rezultuar se subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe nuk ka plotësuar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, duke mos deklaruar faktin që i ka marrë në huapërdorje automjetin shtetasit Xh. T. Në këtë këndvështrim, Komisioni, nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, vlerëson se përgjatë ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar, subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke u plotësuar kushtet dhe rrethanat për zbatimin e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit

6. Kundër vendimit të Komisionit ka ushtruar ankim, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (në vijim “Kolegji”), subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, duke kërkuar:

- *Shqyrtimin në seancë gjyqësore publike të çështjes që i përket vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr.512, datë 25.02.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit Shpëtim Reka.*
- *Shqyrtimin në themel të të gjitha fakteve dhe provave të paraqitura përgjatë hetimit administrativ, si dhe bashkëlidhur ankimit.*
- *Ndryshimin e vendimit nr. 512, datë 25.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Reka, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.*

7. **Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit mbi procesin e rregullt dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si vijojnë:**

(i) Vendimmarrja e Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar, vlerësimit jo të drejtë dhe mungesës të vlerësimit të provave të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ, si dhe interpretimit të gabuar të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit D dhe DH të Aneksit të Kushtetutës.

(ii) Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove me rezultatet e hetimit administrativ lidhur me cenimin e besimit të publikut, duke e bërë procesin e tij të rivlerësimit, në kuptim të parimeve të procesit të rregullt ligjor, të padrejtë dhe të pabarabartë, pasi nuk ka pasur mundësi të paraqesë shpjegime dhe të mbrohet. Subjekti kërkon nga Kolegji të drejtën për t’u dëgjuar në seancë gjyqësore publike, lidhur me shkakun e shkarkimit të cenimit të besimit të publiku.

(iii) Subjekti kërkon nga Kolegji që, në zbatim të procesit të rregullt ligjor dhe garantist, të marrë në konsideratë edhe trajtimin e analizës financiare, si dhe qëndrimin e mbajtur nga një tjetër trup gjykues i Komisionit, i cila ka konfirmuar në detyrë bashkëshorten e tij, F. R. Mbështetur në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, subjekti kërkon që konkluzioni për kontrollin pasurisë së bashkëshortes së tij të aplikohet me të njëjtat parime edhe për të.

8. **Shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:**

8.1. Lidhur me pasurinë “apartament me sipërfaqe 70.7 m,²” ndodhur në rrugën “{***}”, pranë stadiumit {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që, referuar parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, ta vlerësojë të padrejtë dhe të paarsyeshëm qëndrimin e Komisionit për deklarimin e pasaktë të kësaj pasurie, duke konkluduar që kjo situatë nuk ka ndikim në vlerësimin e kriterit të pasurisë së tij, pasi ai ka mundur të justifikojë dhurimin dhe blerjen e pjesshme të kësaj prone me burime të ligjshme.

8.2. Lidhur me pasurinë “apartament 3+1, me sipërfaqe 146.5 m²”, ndodhur në lagjen nr. {***}, rruga “{***}”, kati {***}, Durrës, me vlerë 70.000 euro, subjekti pretendon se Komisioni në çështjen e pagesës së shumës prej 7.000 eurosh ka zgjedhur versionin më të keq të analizës ekonomike, duke rënduar dhe penalizuar me të padrejtë pozitën e tij, për më tepër, kur analizon konfliktin e interesit në

mënyrë të pakuptimtë, e lidh pagesën e kryer me disa ditë para nënshkrimit të kontratës të shitblerjes. Subjekti pretendon se pagesa prej 7.000 eurosh është kryer prej tij gjatë viteve 2006 – 2010 dhe jo në vitin 2011, sikurse ka konkluduar Komisioni.

8.3. Lidhur me pasurinë e deklaruar nga djali i subjektit të rivlerësimit, z. E. R., “apartament me sipërfaqe 51 m²”, ndodhur në lagjen nr. {***}, Durrës, subjekti i rivlerësimit pretendon se këtë pasuri, djali i tij e ka përfutur më anë të testamentit të lënë nga nëna e bashkëshortes së tij, V. A. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka pasur detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të trashëgimlënësës testamentare (nëna e bashkëshortes), për shkak të pamundësisë objektive për të siguruar dokumente të plota, që justifikojnë burimet e ligjshme të financimit të pasurisë “apartament në plazhin e Durrësit”.

8.4. Lidhur me të ardhurat e përfutuara ndër vite nga qiradhënia e apartamentit me sip. 70.7 m², të ndodhur në Tiranë, subjekti kërkon nga Kolegji të konsiderojë si të pabazuara në prova dhe ligj konkluzionet e Komisionit lidhur me moskonsiderimin e të ardhurave nga qiratë, kur provohet se ato janë përfutur nga bashkëshortja e tij (personi i lidhur si qiradhënës) dhe sipas legjislacionit tatimor, nuk identifikohet si subjekt që ka pasur detyrimin për pagimin e tatimeve.

8.5. Lidhur me pasurinë “automjet me targë: {***}”, i cili ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit “Mercedes - Benz”, subjekti i rivlerësimit pretendon se konstatimet e Komisionit, për parregullsi të dokumentacionit të blerjes së këtij automjeti, i përkasin periudhës së vitit 1999. Për sa kohë automjeti nga verifikimet nuk rezulton as si automjet i vjedhur dhe as si automjet me detyrime doganore, subjekti kërkon nga Kolegji që kjo çështje të mos ndikojë në vlerësimin e tij në këtë proces, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

9. Shkaqet e ankimit për kriterin e kontrollit të figurës paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

9.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, se ai nuk ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, pasi nuk ka deklaruar faktin se, në vitin 2012, ka marrë në huapërdorje automjetin e shtetasit Xh. T. (personi i përfshirë në krimin e organizuar), rrethanë e cila klasifikohet sipas nenit 38/4 të ligjit nr. 84/2016, duke pretenduar se:

9.1/a. Në lidhje me këto konstatime është vënë në dijeni nëpërmjet komunikimit gjatë procesit të rivlerësimit të tij në Komision, për këtë arsye nuk ka deklaruar si kontakt të papërshtatshëm faktin e mësipërm në deklaratën për kontrollin e figurës.

9.1/b. Kontakti i vetëm me shtetasin Xh. T. ka ndodhur në kushte krejt rastësore dhe normale, në zyrën noteriale kur është nënshkruar marrja e automjetit në përdorim, me qëllim udhëtimin disaditor me familjen dhe dy nipat e bashkëshortes.

9.1/c. Automjeti me targë: {***} është marrë me qira nga prindërit e fëmijëve që do të shoqëronte ai në udhëtim, pagesa është bërë prej tyre për të gjitha ditët e përdorimit. Për gjetjen e automjetit është interesuar shtetasi N. K. (babai i fëmijëve që do të udhëtonte me ta).

9.1/ç. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që të marrë në konsideratë raportin e DSIK-së, i cili e konsideron të përshtatshëm për vijimin e detyrës, si dhe konkludimin e Komisionit për mospasjen e një marrëdhënie të vazhdueshme me këtë person, situatë kjo që e vendos atë plotësisht në kushtet e parashikuara nga neni 38, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit pretendon se

plotëson të gjitha kushtet për t'u konsideruar se ka disa rrethana lehtësuese, të cilat duhet të merren parasysh në vlerësimin e tij nga Kolegji.

9.2. Lidhur me konstatimin e Komisionit se, gjatë ushtrimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështje gjyqësore në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka udhëtuar me makinën në pronësi të shtetasit R. K., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, subjekti pretendon se vendimmarrja e tij ka qenë e drejtë dhe e pandikuar nga rrethana jashtëgjyqësore. Sipas subjektit, marrëdhënia me shtetasin R. K., asnjëherë nuk ka qenë marrëdhënie shoqërore, por vetëm njohje si bashkëqytetar.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit, z. Shpëtim Reka, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

11. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh⁴ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

12. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, përveç rasteve kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”, i ndryshuar), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me

⁴ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 512, datë 25.02.2022, për rivlerësimin e subjektit, z. Shpëtim Reka, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit, më datë 31.03.2022, kurse ankimi i subjektit rezultoi të jetë depozituar në Komision në datën 12.04.2022, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit, nr. {***}, datë 12.04.2022, që rezultoi të jetë dita e 12-të nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit. Gjatë shqyrtimit të ankimit, Komisioni ka konstatuar se ankimi nuk ishte i saktë nga ana formale, pasi nuk ishin depozituar në tri kopje provat shoqëruese të ankimit. Me shkresën nr. {***}, datë 12.04.2022, “Njoftim për plotësim të metash”, Komisioni ia ka kthyer atë subjektit, i cili, më datë 15.04.2022, ka depozituar në Komision kopje të plotë të provave shoqëruese të ankimit. Komisioni, me vendimin nr. {***}, datë 14.04.2023, ka vendosur të pranojë ankimin e datës 15.04.2022 si ankim të plotë dhe në përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 512, datë 25.02.2022, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

13. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes për gjykim në seancë gjyqësore publike, kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, për të kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vendosi të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.
14. Trupi gjykues, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, shqyrtoi dhe aktet⁵ e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit dhe parashtrimeve para seancës, për t'u marrë në cilësinë e provës dhe konstatoi se ato nuk pasqyrojnë të dhëna të prodhuara për herë të parë pas dhënies së vendimit të Komisionit. Si rrjedhojë, nuk mund të argumentohet që paraqitja e tyre në Komision ka qenë e pamundur. Ky konstatim vlen edhe për aktet që mbajnë datat pas dhënies së vendimit, sikurse: Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.04.2022, e administratorit të shoqërisë “{***}”, z. P. T., dhe ekstrakt i QKB-së, datë 08.04.2022, për veprimtaritë që ushtron shoqëria “{***}” ShPK, apo akte të tjera të nxjerra shumë kohë përpara dhënies së vendimit, sikurse: Shkresë nr. {***}, datë 29.10.2018, e Raiffeisen bank, si dhe kontrata e furnizimit me energji elektrike apo librezë e Ujësjiellës - Kanalizime në emër të subjektit të rivlerësimit. Një pjesë e akteve bashkëlidhur ankimit janë paraqitur edhe gjatë procesit të hetimit në Komision, sikurse deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.07.2021, e shtetasit F. L., deklarata e datës 17.02.2022, e shtetasit N. K. dhe vendimi nr. {***}, datë 04.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
15. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se ato nuk plotësojnë kërkesat e nenit 47⁶ të ligjit nr. 49/2012, pasi subjekti i rivlerësimit nuk provoi që, pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë ato gjatë hetimit administrativ në Komision. Pavarësisht sa më sipër, trupi gjykues, lidhur me vlerën provuese të tyre, konkludoi se, sipas nenit 49, pika 6, shkronjat “a” dhe “c” të ligjit nr. 84/2016, ato nuk janë të nevojshme, pasi nuk përmbajnë ndonjë të dhënë apo fakt që do të ndikonte në shqyrtimin e ankimit.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, që lidhen me procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit

16. Trupi gjykues mori në fillim në shqyrtim pretendimin e subjektit të rivlerësimit në ankim, se vendimmarrja e Komisionit është rezultat i një procesi të paragjykuar, vlerësimit jo të drejtë dhe mungesës të vlerësimit të provave të paraqitura nga ai gjatë hetimit administrativ, si dhe interpretimit të gabuar të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, dhe nenit D e DH të Aneksit të Kushtetutës.

⁵ (i) Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.04.2022, e administratorit të shoqërisë “{***}”, z. P. T., ekstrakt i QKB-së, datë 08.04.2022; (ii) Kontratë nr. {***}, datë 22.07.2005, me Korporatën e Energjisë Elektrike dhe librezë e Ujësjiellës - Kanalizime nr. {***}, në emër të Shpëtim Rekës. Shkresë nr. {***}, datë 29.10.2018, e Raiffeisen Bank; Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.07.2021, e shtetasit F. L.; Deklaratë, e datës 17.02.2022, e shtetasit N. K., vërtetim përkthimi, fotokopje e noterizuar e pasaportës amerikane, në emër të shtetasit N. K., me nr. {***}, lëshuar me datë 07.04.2010, me datë skadence 06.04.2020; Vendim nr. {***}, datë 04.10.2021, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

⁶ Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkojnë prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se, pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj.

16.1. Nga analizimi i akteve të fashikullit gjyqësor administruar në Komision, trupi gjykues konstaton se ndaj subjektit të rivlerësimit është zhvilluar një proces i rregullt ligjor dhe subjekti i rivlerësimit ka pasur në dispozicion të gjithë kohën e nevojshme për t'iu përgjigjur pyetjeve të pyetësorëve dhe për të dhënë shpjegime për rezultatet e hetimit administrativ. Subjekti i rivlerësimit është njohur me dokumentacionin mbi të cilin është bazuar vendimmarrja e Komisionit dhe për këtë ka nënshkruar deklaratën e datës 10.02.2022, për njohjen me dokumentacionin fizik dhe në formë elektronike (CD), të dosjes së hetimit administrativ, duke konfirmuar se nuk ka asnjë vërejtje lidhur me të, fakt i konfirmuar prej tij edhe gjatë seancës dëgjimore. Nga analizimi i procesverbalit të seancës dëgjimore, rezulton që subjekti i rivlerësimit ka pasur kohën e mjaftueshme për të parashtruar shpjegimet mbi rezultatet e hetimit dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të bëra në seancë nga relatorja e çështjes. Nuk rezulton asnjë qëndrim paragjykes i mbajtur nga Komisioni dhe as ndonjë pretendim i ngritur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në këtë drejtim. Procesi i rivlerësimit është kryer sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe rregullatore mbi bazën e të cilave Komisioni e proceson dhe e finalizon atë. Fakti që këto pretendime janë ngritur nga subjekti i rivlerësimit vetëm pas njohjes me vendimin përfundimtar të Komisionit, i bën këto pretendime të pabazuara.

16.2. Trupi gjykues sjell në vëmendje se procesi i rivlerësimit është një proces administrativ i iniciuar, kryesisht, referuar nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, institucionet e rivlerësimit hetojnë, vlerësojnë faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke kërkuar dhe administruar dokumentet për realizimin e hetimit administrativ. Vendimmarrja e Komisionit bazohet në këto dokumente dhe në provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit me përgjigjet e pyetësorëve dhe me shpjegimet për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ, në kuadër të barrës së provës, sipas nenit 52, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Të gjitha aktet shkresore administrohen në dosjen gjyqësore dhe trajtohen në harmoni me provat e tjera. Po kështu, nuk rezulton që Komisioni të ketë përfshirë në vendim elemente të cilat nuk i ka trajtuar gjatë hetimit administrativ dhe për të cilat subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegimet e tij.

16.3. Vendimi objekt shqyrtimi i Komisionit përmban analizën e akteve të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ. Rezulton se Komisioni ia ka nënshtruar vlerësimit të tij provat, duke marrë qëndrim mbi vlerën provuese të akteve të sjella prej subjektit të rivlerësimit. Këto akte janë çmuar përkundër ndikimit që ato kanë mbi çështjet e ngritura, në zbatim të parimit të parashikuar nga neni 81 i Kodit të Procedurave Administrative.⁷ Për sa i përket pretendimeve të subjektit, në lidhje me vlerësimin e akteve të depozituara në Komision në cilësinë e provës, trupi gjykues konstaton se vlerësimi i tyre është bërë nga Komisioni në përputhje me përcaktimet e nenit 49, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sa i përket vlerës provuese të tyre në raport me provat dhe aktet e tjera të administruara gjatë hetimit, si dhe për ndikimin e tyre në konkluzionet dhe në analizën financiare të kryer nga Komisioni. Fakti që këto akte e prova të subjektit, Komisioni nuk i ka vlerësuar në mënyrën e dëshiruar prej tij nuk passjell logjikisht se ka munguar vlerësimi lidhur me to. Ky është edhe interpretimi i vlerësimit të provave zhvilluar nga jurisprudenca e GjEDNj-së, në drejtim të zbatimit në praktikë të garancive të procesit të rregullt ligjor, në çështjen *Wierzbicki k. Polonisë*, 2002⁸.

16.4. Provat në këtë proces janë çmuar në raport me njëra-tjetrën. Komisioni, për subjektin e rivlerësimit Shpëtim Reka ka ndjekur të njëjtën procedurë si edhe për subjektet e tjerë të rivlerësimit,

⁷ “[...] Organi publik çmon, sipas bindjes së tij, se cilat fakte konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave së bashku, si dhe në rezultatin tërësor të hetimit administrativ”.

⁸ Neni 6 i Konventës nuk garanton në mënyrë eksplicite të drejtën për të thirrur dëshmitarë apo për të paraqitur prova të tjera në gjykimet civile. Në lidhje me këtë, gjykata përsërit se vlerësimi i rëndësisë së provave për çështjet konkrete është kompetencë e gjykatave të brendshme.

të përcaktuar nga neni 55 i ligjit nr. 84/2016 dhe akti rregullator i Komisionit, “Hapat proceduralë të unifikuar”, referuar të cilëve, vendimi përfundimtar merret pas bisedimeve përfundimtare me dyer të mbyllura të trupit gjykues, në praninë e vëzhguesit ndërkombëtar, në përfundim të hetimit administrativ dhe zhvillimit të seancës dëgjimore.

16.5. Trupi gjykues konstaton se ishte pikërisht vlerësimi i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk arriti një nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë dhe për kriterin e figurës, si dhe ekzistenca e gjendjes së konfliktit të interesit, që e çuan atë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar me sjelljen e tij profesionale besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Ky vlerësim është rezultat i interpretimit të Komisionit të dispozitave ligjore përkatëse në rrethanat e faktit dhe jo pasojë e moskonsiderimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura prej tij. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se pretendimet e subjektit të rivlerësimit janë të pabazuara.

16.6. Pavarësisht këtij konstatimi, këto pretendime të subjektit të rivlerësimit do të analizohen më poshtë në këtë vendim, së bashku me shkaqet e ankimit me natyrë materiale, që lidhen me analizimin e problematikave të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

- 17.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se Komisioni nuk i ka kaluar barrë prove me rezultatet e hetimit administrativ lidhur me cenimin e besimit të publikut, duke e bërë procesin e tij të rivlerësimit, në kuptim të parimeve të procesit të rregullt ligjor, të padrejtë dhe të pabarabartë, pasi nuk ka pasur mundësi të paraqesë shpjegime dhe të mbrohet, duke kërkuar nga Kolegji të drejtën për t’u dëgjuar në seancë gjyqësore lidhur me shkakun e shkarkimit të cenimit të besimit të publiku, trupi gjykues vlerëson se:

17.1. Komisioni nuk mund të konkludonte për cenim të besimit të publikut gjatë hetimit, përderisa procesi i shqyrtimit vazhdonte, më tej do të zhvillohej seanca dëgjimore dhe subjekti, në kuadër të parimit të kontradiktoritetit, kishte të drejtë të paraqiste prova, materiale, shpjegime dhe parashtrime të tij. Nëse Komisioni do të konkludonte për cenim të besimit të publiku në përfundim të hetimit paraprak, atëherë ai do të paragjykonte çështjen, pasi me kalimin e barrës së provës subjektit, mund të ndodhte që me provat e sjella, si gjatë hetimit, ashtu dhe në seancën dëgjimore, mund të përmysej rezultati i hetimit. Subjektit të rivlerësimit, ndryshe nga sa pretendon, i është garantuar gjithashtu e drejta për t’u mbrojtur, pasi informacioni që mori pas përfundimit të hetimit administrativ, i ka mundësuar atij që të kuptonte seriozitetin e gjetjeve paraprake, me qëllim përgatitjen e mbrojtjes së përshtatshme. Atij iu dha akses në dokumentacionin e çështjes dhe në metodologjinë e përdorur për kryerjen e analizës financiare, në mënyrë që të përgatiste mbrojtjen, për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se shkakun i mësipërm i ankimit, i ngritur nga subjekti, nuk qëndron dhe është i pabazuar.

- 18.** Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që, në zbatim të procesit të rregullt ligjor dhe garantist, të marrë në konsideratë edhe trajtimin e analizës financiare, si dhe qëndrimin e mbajtur nga një tjetër trup gjykues i Komisionit, e cili ka konfirmuar në detyrë bashkëshorten e tij, F. R. Mbështetur në parimet e objektivitetit dhe proporcionalitetit, subjekti kërkon që konkluzioni për kontrollin pasurisë së bashkëshortes së tij të aplikohet me të njëjtat parime edhe për të.

18.1. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues thekson se, referuar nenit Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, rivlerësimi i subjekteve për kriterin e kontrollit të pasurive kryhet nga organet e rivlerësimit, në përputhje me përcaktimet e nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016. Në kuptim të dispozitës së sipërcituar kushtetuese dhe Kreut IV të ligjit nr. 84/2016, çdo pasuri, sipas kuptimit të dhënë në nenin 3, pika 11 e këtij ligji, që është objekt

deklarimi në deklaratën e pasurisë *vetting*, i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklarimit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim, i artikuluar ky sipas kriterit të kohës së krijimit apo çdo lloj kriteri tjetër përcaktues.

18.2. Në referim të kuadrit kushtetues dhe ligjor të zbatueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, konstatohet se, në asnjë prej dispozitave të këtij korpusi ligjor, nuk parashikohet ndonjë normë juridike, sipas së cilës të vendosen kriteret vlerësimi lidhur me pasuritë e subjekteve dhe të personave të lidhur, me qëllim përfshirjen apo përjashtimin e tyre nga objekti i kontrollit të organeve të rivlerësimit, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe Kreut IV të ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, secili subjekt rivlerësimi duhet të rivlerësohet në mënyrë të pavarur, jo vetëm në kriteret e figurës dhe të aftësisë profesionale, të cilat janë thellësisht individuale, por edhe në kriterin e pasurisë, si një kriter që përfshin edhe persona të tjerë në marrëdhënie pronësie, persona të lidhur apo të tjerë të lidhur.

18.3. Nga sa më lart, trupi gjykues vëren se, në rastin konkret, qenia e dy subjekteve të rivlerësimit njëkohësisht edhe bashkëshortë, si dhe pasja e pasurive të përbashkëta në objekt të shqyrtimit, në proceset e tyre të rivlerësimit, nuk afekton procesin e bashkëshortit tjetër në kohë, edhe pse kanë pasuri të përbashkëta, pasi subjektet e rivlerësimit që janë subjekt i nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, kanë të drejtën e një procesi rivlerësimi të pavarur, bazuar vetëm në provat që i përkasin çështjes së tyre dhe konsiderohen procese me palë të ndryshme.

18.4. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson se, për sa kohë shqyrtimi i ankimit të subjektit do të kryhet në Kolegj, duke u referuar në aktet e çështjes që i përkasin asaj të administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, është e panevojshme dhe e paarsyeshme të kryhen kontrole apo referime mbi elemente të caktuara të vlerësimit të pasurisë, që Komisioni ka bërë në një vendim tjetër të tij. Për pasojë, ky pretendim i subjektit nuk pengon Kolegjin të bëjë një vlerësim të pavarur të shkaqeve të ankimit objekt shqyrtimi, pavarësisht qëndrimeve që ka mbajtur Komisioni në raste të tjera (përfshirë edhe bashkëshorten e subjektit, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit), të cilat janë të pavlerësuara prej Kolegjit.

18.5. Lidhur me sa më lart, trupi gjykues vlerëson se një pretendim i tillë i subjektit të rivlerësimit nuk mund të përbëjë *a priori* shkak procedural për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, sipas shkaqeve konkrete të ankimit, të cilat lidhen me vlerësimin e kriterëve të rivlerësimit bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe zbatimit të duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjerë të rivlerësimit nga Komisioni. Një qëndrim i tillë i Kolegjit është tashmë i konsoliduar në praktikën e tij gjyqësore⁹.

18.6. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se Kolegji duhet të marrë në konsideratë raportin e DSIK-së, i cili e konsideron të përshtatshëm për vijimin e detyrës, trupi gjykues çmon të theksojë se procesi i rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve kryhet nga Komisioni në bazë dhe për zbatim të parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës, neneve të Aneksit të saj dhe dispozitave të ligjit nr. 84/2016, ndonëse e ka pikënisjen nga raportet e përpiluara nga organet ndihmëse të përcaktuara me ligj (ILDKPKI, DSIK dhe Inspektorati i KLD-së/KLGj/KLP), për të bërë vlerësimin e secilit prej tri kriterëve të rivlerësimit, i nënshtrohet një procesi të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi nga Komisioni, dhe që referuar edhe qëndrimit të Gjykatës Kushtetuese në vendimin e saj nr. 2/2017, organet e rivlerësimit nuk janë të detyruara t'i marrin *a priori* në konsideratë gjetjet

⁹ Shih vendimin e Kolegjit nr. 7/2019 (JR), datë 05.04.2019.

e grupit të punës të DSIK-së, pasi ato kanë akses të drejtpërdrejtë në të gjitha bazat e të dhënave qeveritare. Në kontekst të sa më sipër, ky shkak ankimi çmohet pa relevancë në zgjidhjen e çështjes, sa kohë objekt i kontrollit të Kolegjit janë konkluzionet përfundimtare të arritura nga Komisioni dhe të kundërshtuara nëpërmjet ankimit nga subjekti i rivlerësimit, lidhur me kriteret e rivlerësimit të tij.

19. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se procedura e ndjekur nga ana e Komisionit, në trajtimin e kërkesave të subjektit për marrjen e provave, rezulton të jetë kryer në përputhje me parashikimet e nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016. Pasi u kontrollua zhvillimi i procesit të tij të rivlerësimit në Komision, si dhe u vlerësua dokumentacioni i fashikujve të administruar gjatë hetimit në Komision, trupi gjykues konstaton se nuk janë kryer shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi të vijojë me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit, që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

20. Për pasurinë “apartament” ndodhur në rrugën “{*}”, Tiranë, me sipërfaqe 70.7m²**

20.1. Subjekti i rivlerësimit shkakun e ngritur në ankim, për kundërshtimin e qëndrimit të Komisionit në vendim, *se shpjegimet e dhëna prej tij mbi mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie dhe çmimin e blerjes së saj nuk janë të provuara me dokumentacion dhe mbeten në nivel deklarativ*, e mbështeti në pretendimet e mëposhtme:

20.1/a. Sipas subjektit, ai ka dokumentuar qartë se apartamenti është fituar në mënyrë të ligjshme nga bashkëshortja e tij dhe origjina e kësaj prone provohet me prova shkresore. Apartamenti me sipërfaqe 70.7m² është fituar në vitin 2000, me veprime të ligjshme dhe ka ndjekur ecurinë e kalimit nga gjyshja te babai, nga babai te vëllai dhe bashkëshortja e tij. Ky apartament i është dhuruar bashkëshortes F. R. nga babai i saj, z. J. A., dhe është blerë pjesërisht një sipërfaqe, prej afërsisht 10-12 m².

20.1/b. Lidhur me çmimin e blerjes së pasurisë, subjekti pretendon se vlera prej 900.000 lekësh, e vendosur në kontratën e shitjes, ka qenë për efekt të vendosjes së një shifre të përafërt me çmimet e tregut dhe, për këtë arsye, është bërë deklarimi në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, në vitin 2003, ndërsa vlera prej 500.000 lekësh tregon vlerën e paguar nga bashkëshortja.

20.1/c. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që, referuar parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, ta vlerësojë të padrejtë dhe të paarsyeshëm qëndrimin e Komisionit për deklarimin e pasaktë të kësaj pasurie, duke konkluduar që kjo situatë nuk ka ndikim në vlerësimin e kriterit të pasurisë së tij, pasi ai ka mundur të justifikojë dhurimin dhe blerjen e pjesshme të kësaj prone me burime të ligjshme.

20.2. Lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues mori në shqyrtim deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, dorëzuar në ILDKPKI, si dhe dokumentacionin e ndodhur në fashikujt e Komisionit, ku rezultoi se:

20.2/a. Në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se kjo pasuri është fituar në vitin 2000, dhuruar bashkëshortes F. R. nga babai J. A. dhe pjesërisht e blerë (përafërsisht 10-12 m²). *Kjo pasuri rrjedh nga ndërtimi mbi truallin e trashëguar dhe kthyer me vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave nr. {***}, datë 30.06.1995, z. J. A. dhe trashëgimtarëve*

të tij. Veprimi juridik është pasqyruar në kontratën e shitjes datë 23.06.2000, nr.{***}, ndërmjet shtetasit I. A. (vëllai i bashkëshortes) dhe blerëses F. R. Vlera e shpenzuar prej meje ka qenë në shumën 500.000 lekë. Dhurimi i pjesës së apartamentit në natyrë është i padokumentuar, pasi dhurimi për efekt të dokumentacionit i është bërë z. I. A., me kontratën datë 19.01.1998, nr. {***}.

20.2/b. Subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim pasurie, në vitin 2003, si burim për këtë pasuri deklaroi: “i trashëguar prej bashkëshortes time dhe pjesërisht i blerë, vetëm 14 m² (pasi pjesa tjetër është trashëguar), nga të ardhurat e punës time dhe të bashkëshortes”, dhe vlerë pasurie 900.000 lekë.

20.2/c. Lidhur me mënyrën e përfitimit të këtij apartamenti, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se: “Kjo pasuri rrjedh nga ndërtimi mbi truallin e trashëguar prej bashkëshortes, nga F. A.(N.), gjyshja e saj. Ky truall i është kthyer nga procesi i kthimit dhe kompensimit të pronave, ish-pronarëve, me vendim të Komisionit të Kthimit Pronave, nr. {***}, datë 30.06.1995... Këtë truall, të përfituar nga vendimi i mësipërm, babai i bashkëshortes, J. A., me kontratën nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19 janar 1998, ia ka dhuruar djalit, I. J. A. Që në fillim të veprimeve për dhurimin e truallit dhe përpilimin e dokumentacionit ligjor për kryerjen më pas të ndërtimit, babai i bashkëshortes kishte shfaqur dëshirën që në rast se do realizohej ndërtimi, F. do të merrte ¼ e pjesës së tij, si banesë. Sqaroj se, ndonëse kontrata e shitjes është realizuar për apartamentin me sipërfaqe 70.7 m², shuma prej 500.000 (pesëqind mijë) lekë, e shpenzuar prej meje dhe bashkëshortes për këtë apartament, përfaqëson vetëm vlerën e sipërfaqes prej 10-12 metër, që bashkëshortja ka marrë më shumë sesa sipërfaqja e dhuruar nga babai. Pjesa e sipërfaqes që është dhuruar nga babai i bashkëshortes, në prani edhe të vëllait të saj, është e padokumentuar me shkrim, për shkak të marrëdhënies së afërt familjare ndërmjet tyre... Për këtë shkak është përpiluar me vullnet të palëve kontrata e shitjes, e cila pasqyron çmimin e apartamentit prej 900.000 lekë. Vlera e shënuar në kontratë, me sa kujtojmë, ka qenë vlera e përafërt e çmimeve të tregut të apartamenteve në kohën e ndërtimit të këtij objekti. E përfshirë në këtë çmim është edhe shuma prej 500.000 lekë, të cilën bashkëshortja F. i kishte paguar vëllait, I. A., përpara përpilimit të kontratës, pasi sikurse u shpjegua, sipërfaqja e apartamentit që ajo ka marrë, ishte rreth 10-12 m² më e madhe sesa pjesa që babai kishte mundësi t’i dhuronte”.

20.3. Në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit, që lidhet me origjinën e kësaj pasurie, trupi gjykues analizoi dokumentacionin e depozituar nga subjekti bashkëlidhur deklaratës së pasurisë vetting,¹⁰ si dhe atë të përcjellë nga ASHK-ja, ku rezulton se:

20.3/a. Me kontratë shitje nr.{***} datë 23.06.2000, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, F. R., ka blerë nga vëllai i saj, I. A., apartament me sip. 70.7 m,² ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë. Sipas kontratës së shitjes rezulton se shitësi ia shet këtë pasuri blerëses për çmimin 900.000 lekë, shumë e cila është likuiduar plotësisht. Sipas mandatarkëtimit bashkëlidhur kontratës së shitjes rezulton se I. A. ka paguar tatimin mbi kalimin e të drejtës së pronësisë së apartamentit, në vlerën 4.500 lekë¹¹.

¹⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vetting: (i) Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 12.11.2012, me nr. pasurie {***}; (ii) Kartelë pasurie në pronësi të F. R.; (iii) Vendim K.K.K Pronave, nr. {***}, dt. 30.06.1995; (iv) Vërtetim pronësie, dt.19.01.1998, sipas të cilit në Regjistrin hipotekor nr.{***}, dt.4.11.1996, në pronësi të J. A. dhe P. A. figurojnë të regjistruar dy troje të lira me sip. 288 m² secili, ku J. A. zotëron ¾ pjesë; (v) Kontratë dhurimi, datë 19.01.1998, me palë dhuruese J. A. dhe palë pranuese e dhurimit I. A.; (vi) Vërtetim hipotekor nr. {***}, dt.23.06.2000, për garazh me sip. 267 m², ambient shërbimi në katin përdhe, apartament me sip. 70.7 m,² me adresë: rruga “{***}”, Tiranë, në pronësi të I. A.; (vii) Kontratë shitje, datë 23.06.2000, me palë shitëse I. A. dhe palë blerëse F. R., për pasuritë “për garazh me sip. 267m²”, “ambient shërbimi në katin përdhe”, “apartament me sip. 70.7 m², me adresë rruga “{***}”, Tiranë.

¹¹ Vlera e paguar korrespondon me 0,5 % të vlerës së çmimit të blerjes së kësaj pasurie, prej 900.000 lekësh.

Bazuar në kartelën e pasurisë, apartamenti me sip. 70.7 m² ka nr. pasurie {***}, Zona Kadastrale {***} dhe është regjistruar në pronësi të bashkëshortes së subjektit, znj. F. R.

20.3/b. Në origjinën e tij, fillimisht, trualli me nr. pasurie {***} është regjistruar në bashkëpronësi të 12 bashkëpronarëve të familjes A. e H. Nëpërmjet kontratës së shitjes, kjo pasuri ka kaluar në pronësi të J. A. (babait të bashkëshortes) dhe P. A.¹². Me kontratë dhurimi datë 19.01.1998, J. A. i ka dhuruar djalit të tij (vëllait të bashkëshortes) I. A., $\frac{3}{4}$ pjesë takuese në trojet me sipërfaqe respektive 288 m,² ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë. Përmes këtij dhurimi, këto troje u regjistruan në pronësi të I. A., me $\frac{3}{4}$ pjesë takuese dhe P. A., me $\frac{1}{4}$ pjesë takuese.

Në vijim, pronarët e kësaj pasurie kanë nënshkruar kontratë porosie datë 28.02.1998, me sipërmarrësin Sh. B., për ndërtimin e një objekti 8-katësh¹³, nga i cili, porositësi I. A. do të përfitonte 17% të apartamenteve të objektit, ndërsa porositësja P. A. (Z.) do të përfitonte 5% të tyre.

Sipas kësaj kontrate, porositësi I. A. ka përfituar me kontratën e shkëmbimit pasuritë 167 m² garazhe, ambiente shërbimi në katin përdhe, me sipërfaqe 350 m² dhe një apartament me sip. 70.7 m². Nga apartamentet e përfituara, me kontratë shitje nr. {***}, datë 23.06.2000, I. A. ka tjetërsuar në favor të motrës së tij, F. R., apartamentin me sip. 70.7 m,² me nr. pasurie {***}.

20.3/c. Subjekti ka depozituar në Komision deklaratën noteriale nr. {***}, datë 09.03.2020, përmes së cilës I. A. deklaron se apartamentin 70.7 m² e ka kaluar në favor të motrës së tij, duke përmbushur kështu vullnetin e babait, si dhe ka realizuar shitjen e sipërfaqes 10-12 m² të këtij apartamenti në favor të motrës së tij, F. R.

20.4. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të mësipërme, konstaton se origjina e kësaj prone provohet me dokumentacion shkresor referuar dispozitave të Kodit Civil. Ndërsa, lidhur me pretendimin e subjektit, se vetëm një pjesë e sipërfaqes së kësaj pasurie është blerë, pasi pjesa tjetër është dhuruar, trupi gjykues konstaton se në kontratën e shitjes nr. {***}, datë 23.06.2000, të mbajtur midis blerësit I. A. dhe blerëses F. R., nuk përcaktohet ndonjë sipërfaqe e dhuruar apo e trashëguar, por citohet shitja e apartamentit në total për sipërfaqen 70.7 m², në vlerën 900.000 lekë, për më tepër nuk konstatohet të jetë depozituar dokumentacion ligjor provues mbi këtë fakt. Deklarata noteriale nr. {***}, datë 09.03.2020, e vëllait të bashkëshortes së subjektit, I. A., i cili konfirmon thëniet e subjektit të rivlerësimit, ka një vlerë të kufizuar provuese në këtë proces, pasi është hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, është përpiluar nga një i afërm i tij dhe kërkohet të vërtetohen fakte që shkojnë në favor të subjektit.

Gjithashtu, nuk rezulton që subjekti të ketë dorëzuar dokumentacion që vërteton përfitimin e pjesëve takuese të pjesëtarëve të tjerë mbi këtë pronë. Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.12.2021, depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ, vërteton faktin se trashëgimtarët e V. A. (djemtë dhe vajzat) kanë përfituar pas vdekjes së nënës së tyre, nga trashëgimia ligjore, pasurinë “apartament banimi”, në rrugën “{***}”, por nuk vërteton përfitimin e pjesëve të tyre mbi pronën objekt analize. Nga sa më lart, trupi gjykues vëren se qëndron problematika e konstatuar nga Komisioni lidhur mosdokumentimin me shkrim të sipërfaqes së dhuruar nga babai i bashkëshortes së subjektit.

¹² Motra e babait të bashkëshortes së subjektit.

¹³ Objekti i mësipërm rezulton të jetë ndërtuar mbi bazën e lejes së ndërtimit nr. {***}, datë 29.06.1998, miratuar nga Bashkia Tiranë, në favor të shoqërisë “{***}” SHPK, me përfaqësues ligjor z. I. A.

20.4/a. Lidhur me çmimin e blerjes së kësaj pasurie, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlera të ndryshme deklarimi, pasi në kontratën e shitjes është përcaktuar çmimi në vlerën prej 900.000 lekësh, ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar se vlera e shpenzuar prej tij është 500.000 lekë. Megjithëse nga analiza financiare e kryer në Komision ka rezultuar që ai dhe bashkëshortja kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e pasurisë, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar saktësisht çmimin e blerjes së kësaj pasurie.

20.5. Në përfundim të analizimit të këtij shkaku ankimi trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar saktësisht mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie dhe çmimin e blerjes së saj në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe do të vlerësojë peshën e saj në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, për shkak të një vlerësimi që lidhet me të gjitha rrethanat e çështjes.

21. Lidhur me pasurinë “apartament 3+1 me sipërfaqe 146.5 m²”, ndodhur në lagjen nr. {*}, rruga “{***}”, kati {***}, Durrës, me vlerë 70.000 euro:**

21.1. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, për momentin e likuidimit të kështit të fundit të blerjes së apartamentit, prej 7.000 eurosh, në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, vlerësoi se ato nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në prova, por mbeten në nivel deklarativ. Subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion për të provuar pretendimin e tij se pagesat janë kryer gjatë periudhës 2006 – 2010, nuk rezulton të ketë deklaruar shlyerjen e kësaj shume në deklaratën e interesave periodikë të viteve 2006 – 2010. Në lidhje me shlyerjen e kësaj shume, Komisioni vlerësoi se subjekti ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, duke e vlerësuar këtë defekt dhe peshën e tij në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, në të gjitha elementet e tij. Në analizën financiare, shuma 7.000 euro është konsideruar prej Komisionit si e shlyer në vitin 2011, përpara lidhjes së kontratës së shitblerjes.

21.2. Subjekti pretendon se Komisioni në çështjen e pagesës së shumës prej 7.000 eurosh, ka zgjedhur versionin më të keq të analizës ekonomike, duke rënduar dhe penalizuar me të padrejtë pozitën e tij, për më tepër kur analizon konfliktin e interesit, në mënyrë të pakuptimtë e lidh pagesën me disa ditë para nënshkrimit të kontratës. Subjekti pretendon se pagesa prej 7.000 eurosh është kryer prej tij përgjatë viteve 2006 - 2010 dhe jo në vitin 2011 sikurse ka konkluduar Komisioni.

21.3. Trupi gjykues, lidhur me këtë shkak ankimi, mori në shqyrtim deklaramet e subjektit të rivlerësimit, si dhe analizoi dokumentacionin e administruar në Komision për këtë pasuri, ku rezultoi se:

21.3/a. Në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë *vetting*, subjekti ka deklaruar se: *Pasuria është blerë me kontratën e shitjes me rezervë, dt. 20.05.2004, nr. {***}; Përpiluar kontrata e shitjes, datë 18.11.2011, nr. {***}, me shitësit shoqëria “{***}” SHPK dhe Shpëtim e F. R. Të ardhurat për këtë pasuri janë siguruar nga kredia e marrë pranë BKT, në shumën 31.000 euro, me kontratë kredie bankare, datë 17.12.2004, me kredimarrës F. R. e dorëzanës Shpëtim Reka. Si garanci për pagimin e kredisë është vendosur në hipotekë apartament 1+1, me sip.70 m² në rr. “{***}” dhe është lidhur kontrata e hipotekimit dt.17.12.2004, nr. {***}. Shlyerja e kësaj kredie ka përfunduar në vitin 2015. Të ardhurat për këtë apartament janë siguruar gjithashtu nga shitja e banesës së mëparshme (e blerë nga privatizimi në vitin 1993) me vendndodhje në lagjen {***}, në Durrës. Për këtë shitje është përpiluar kontrata dt.15.07.2005, nr. {***}, me palë shitëse Shpëtim e F. R. dhe palë blerëse Sh. R. Çmimi i shitjes së këtij apartamenti është 3.300.000 lekë. Pjesa tjetër e vlerës së apartamentit është*

siguruar nga të ardhurat nga paga dhe nga qiraja e apartamentit 1+1, me sipërfaqe 70.07 m,² në rr. “{***}”. Apartamenti i mësipërm është regjistruar me nr. pasurie {***}, ZK {***}, në emër të F. dhe Shpëtim Reka. Në këtë apartament banojmë aktualisht unë, bashkëshortja dhe fëmijët.

21.3/b. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë pasuri në vitin e blerjes së saj, në DIPP/2004, por e ka deklaruar në vitin vijues, në DIPP/2005, me përshkrim: “*blerë një apartament 3+1, ndodhur në lagjen nr. {***}, Durrës. Pasuria është ende e paregjistruar. Nga vlera e saj e plotë, prej 70,000 eurosh, janë shlyer 60,000 euro. Pjesa në zotërim 50%*”.

21.3/c. Në DIPP/2011, subjekti ka deklaruar: “*Pasuria apartament 3+1, ndodhur në lagjen nr. {***}, Durrës, është regjistruar në ZVRPP-në Durrës, datë 1.12.2011, në pronësi të Shpëtim dhe F. R. Vlera 70.000 euro e shlyer tërësisht sipas deklarimeve të mëparshme*”.

21.3/ç. Me kontratë shitje me rezervë, datë 20.05.2004, nr. {***}, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë blerë nga shoqëria “{***}” ShPK, apartament me sipërfaqe 160 m,² ndodhur në rrugën “{***}”, Durrës, me vlerë 70.000 euro. Sipas nenit 7 të kësaj kontrate, pagesa e çmimit të apartamentit do të kryhej si më poshtë: (i) Kësti i parë, në vlerën 10.000 euro, do të likuidohej në momentin e lidhjes së kontratës (shumë e cila është likuiduar). (ii) Kësti i dytë, në vlerën 35.000 euro, do të likuidohej nga blerësi me marrjen e kredisë nga banka. (iii) Kësti i tretë, në vlerën 18.000 euro, do të likuidohej në maj 2005. (iv) Kësti i fundit, në vlerën 7.000 euro, do të likuidohej përpara dorëzimit efektiv të apartamentit dhe para përfundimit të formaliteteve për kalimin e pronësisë.

21.3/d. Me kontratë shitje nr. {***}, datë 18.11.2011, subjekti dhe bashkëshortja e tij kanë finalizuar blerjen e apartamentit, me sipërfaqe 146.5 m,² me nr. pasurie {***}, kati {***}, apartamenti {***}. Në përmbajtje të kontratës përfundimtare të shitjes, palët deklarojnë se çmimi i shitjes së apartamentit, në vlerën 70.000 euro, është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale dhe se blerësi ka marrë në dorëzim apartamentin. Bashkëlidhur gjenden mandatarkëtimet,¹⁴ sipas të cilave Shpëtim Reka ka arkëtuar në favor të “{***}” ShPK, pagesat për blerjen e apartamentit objekt analize. Sipas mandateve të mësipërme rezulton se subjekti ka paguar në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, shumën totale prej 63.000 eurosh. Nga kjo shumë, vlera prej 60.000 euro është shlyer deri në muajin dhjetor të vitit 2005, në përputhje me deklarin e kryer nga subjekti në deklaratën periodike të vitit 2005. Diferenca prej 3.000 euro është shlyer në janar të vitit 2006. Konstatohet se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues për pagesën e kështit të fundit prej 7.000 eurosh.

21.4. Trupi gjykues i Kolegjit, ashtu si edhe Komisioni, vlerëson se, bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “*Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë*”, subjekti ka pasur detyrim të deklarojë pasurinë e blerë përmes kontratës së shitblerjes me rezervë, datë 20.05.2004, në deklaratën vjetore të pasurisë të vitit 2004. Në këndvështrim të ligjit të sipërcituar, detyrimi për deklarin nuk lidhet me momentin e kryerjes së pagesave dhe finalizimit të marrëdhënies kontraktore mes subjektit deklarues dhe shitësit

¹⁴ Mandat arkëtimi nr. {***}, datë 22.05.2004, sipas të cilit Shpëtim Reka arkëton në favor të “{***}” SHPK shumën 10.000 euro. Mandat arkëtimi nr. {***}, datë 03.11.2004, sipas të cilit Shpëtim Reka arkëton në favor të “{***}” SHPK shumën 10.000 euro. Mandat arkëtimi nr. {***}, datë 15.01.2005, sipas të cilit Shpëtim Reka arkëton në favor të “{***}” SHPK shumën 25.000 euro. Mandat arkëtimi nr. {***}, datë 19.08.2005, sipas të cilit Shpëtim Reka arkëton në favor të “{***}” SHPK shumën 10.000 euro. Mandat arkëtimi nr. {***}, datë 20.12.2005, sipas të cilit Shpëtim Reka arkëton në favor të “{***}” SHPK shumën 5.000 euro. Të gjitha mandatet kanë përshkrimin: “pagesë pjesore për blerje apartamenti”. Mandat arkëtimi nr. {***}, datë 19.10.2005, sipas të cilit Shpëtim Reka arkëton në favor të “{***}” SHPK shumën 20.600 lekë, me përshkrim: “KESH – Kontrata nr. {***}”. Mandat arkëtimi nr. {***}, datë 01.06.2006, sipas të cilit Shpëtim Reka arkëton në favor të “{***}” SHPK shumën 3.000 euro, me përshkrim: “pagesë pjesore për blerje apartamenti”.

të pasurisë së paluajtshme, por me momentin që subjekti deklarues nënshkruan një akt, përmes të cilit merr përsipër të drejta dhe detyrime me karakter pasuror.

21.5. Lidhur me përcaktimin e datës së pagesës së këstit të fundit të çmimit të blerjes, në vlerën 7.000 euro, gjatë hetimit administrativ në Komision subjekti ka sqaruar se: *“Në lidhje me pagesën e këstit të fundit, për apartamentin e blerë nga shoqëria ‘{***}’ SHPK, kemi respektuar të gjitha kushtet e shënuara në kontratën e shitblerjes me rezervë, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.05.2004, ku në pikën 7 parashikohet se: “Blerësi detyrohet t’i paguajë shitësit këstin e fundit prej 10% të vlerës së përgjithshme të apartamentit (7.000 euro), para dorëzimit efektiv të apartamentit dhe para përfundimit të formaliteteve për kalimin e pronësisë”. Ne kemi kryer pagesën e këstit të fundit në lidhje me apartamentin, përpara përpilimit të kontratës së shitjes, pra përpara datës 18.11.2011”.*

21.5/a. Në ankimin e paraqitur në Kolegj, subjekti ka parashtruar se nuk disponon dokumentacion,¹⁵ që përcakton saktësisht kohën e shlyerjes për pjesën e mbetur prej 7.000 eurosh, por deklaroi se kjo shumë është shlyer pjesë-pjesë, nga subjekti në mirëbesim, gjatë viteve 2006 – 2010, pra, përpara datës 18.11.2011. Këtë pretendim subjekti e mbështet në argumentin se kontratat e furnizimit me energji elektrike dhe me Ujësjellës - Kanalizime janë në emrin e tij prej vitit 2005 dhe, nëse nuk do të kishte likuiduar vlerën e plotë të apartamentit, kompania ndërtuese nuk do t’i kalonte këto kontrata në emër të tij. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka bashkëlidhur ankimit disa akte¹⁶.

21.5/b. Lidhur me aktet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit bashkëlidhur ankimit, trupi gjykues çmon se deklarata noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.04.2022, e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, z. P. T., merr një vlerë të kufizuar në provimin e thënieve të tij, jo vetëm për faktin se është hartuar gjatë procesit të rivlerësimit, por edhe për faktin se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar një çështje gjyqësore me palë shoqërinë “{***}” ShPK (kjo situatë e konfliktit të interesit është analizuar më poshtë në këtë vendim). Ndërsa, kontrata e furnizimit me energji elektrike dhe librezë e furnizimit me ujë mund të vërtetojnë faktin se subjekti ka banuar në këtë apartament prej vitit 2005, por nuk ndihmojnë në evidentimin e kryerjes së pagesave prej subjektit shoqërisë “{***}” ShPK dhe, aq më pak, në përcaktimin e periudhës kohore se kur mund të jenë kryer ato.

21.6. Trupit gjykues, nga analiza e akteve të administruara, i rezultoi se mbetet e paprovuar me dokumentacion justifikues ligjor likuidimi i vlerës prej 7.000 eurosh, prej subjektit të rivlerësimit në favor të shoqërisë ndërtuese “{***}” ShPK, e gjithashtu mbetet në nivel deklarativ pretendimi i subjektit se kjo shumë është shlyer gjatë viteve 2006 – 2010 dhe jo në vitin 2011, kur është nënshkruar kontrata përfundimtare e shitjes së apartamentit.

21.7. Nga sa më lart, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk e ka deklaruar në deklaratat periodike të viteve 2006 – 2010, shlyerjen e vlerës prej 7.000 euro, të parashikuar në kontratën e shitjes me rezervë, datë 20.05.2004, si këst të fundit për likuidimin e plotë të vlerës së apartamentit. Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për sa i përket pasaktësive në deklaratat periodike, trupi gjykues, në mbështetje të qëndrimit të mbajtur

¹⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur parashtrimeve të tij korrespondencën me email me administratorin e shoqërisë “{***}” ShPK, z. P. T., i cili shprehet se subjekti ka shlyer totalisht pagesën ndaj shoqërisë dhe mbi bazën e tyre është lidhur kontrata përfundimtare e shitjes.

¹⁶ (i) Deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.04.2022, të administratorit të shoqërisë “{***}” SHPK, P. T., i cili deklaroi se shoqëria nuk disponon dokumentacion, ku përcaktohen datat e likuidimit të shumave nga Shpëtim e F. R., por likuidimi i plotë i vlerës së apartamentit është bërë para hapjes së procesit gjyqësor civil nga shoqëria me pronarët e truallit (padija e ngritur nga shoqëria “{***}” SHPK është regjistruar në gjykatë më datë 24.02.2010). (ii) Kontratën e furnizimit me energji elektrike në emër të subjektit, datë 22.07.2005. (iii) Librezën e furnizimit me ujë të ndërmarrjes së Ujësjellës - Kanalizime, Durrës, në emër të subjektit, nr. {***}, që i përket viteve 2005 – 2010.

në çështje të ngjashme të tij,¹⁷ vlerëson se një deklaram i pasaktë në deklarimet e mëparshme periodike të interesave nuk mund të konsiderohet se është bërë në kundërshtim me përcaktimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçant, që prodhon situatën e deklarimit të pamjaftueshëm.

21.8. Në përfundim të analizimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasqyruar saktësisht mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie dhe çmimit të blerjes së saj dhe do të vlerësojë peshën e saj në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, bazuar në një vlerësim që lidhet me të gjitha rrethanat e çështjes.

21.9. Në lidhje me aftësinë financiare të subjektit për blerjen e apartamentit, trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, kontrollon analizën financiare të Komisionit mbi mundësitë e subjektit për kryerjen e pagesave të dokumentuara, për blerjen e apartamentit, ku rezultoi se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për kryerjen e pagesave të datave 22 maj 2004, 3 nëntor 2004 dhe 1 qershor 2006. Në përfundim, rezultoi se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit në shumën 936.112,05 lekë.

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti, në vitin 2004, ka pasur gjendje *cash* në shumën 1.000.000 lekë, si dhe ka një rezultat pozitiv në vitin 2005, në shumën 2.411.229,82 lekë, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, vlerësoi se këto fakte mund të tregojnë për pasaktësi në deklarimet periodike vjetore të kursimeve *cash* në vite të subjektit, por nuk janë të mjaftueshme për t’u konsideruar si deklarim i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke çmuar ta vlerësojë peshën e tyre në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, sipas një vlerësimi që lidhet me të gjitha rrethanat e çështjes

22. Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit

22.1. Gjatë analizimit të pasurisë “apartament 3+1, me sipërfaqe 146.5 m²”, ndodhur në Durrës, blerë nga shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, me vlerë 70.000 euro, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit, ka gjykuar kërkesën e shoqërisë “{***}” ShPK për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, në kushtet e konfliktit të interesit, dhe ka vlerësuar këtë situatë të subjektit si pjesë të vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

22.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, se ka gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit, pasi i vetmi gjykim i zhvilluar prej tij me palë shoqërinë “{***}” ShPK i përket vendimit të datës 25.07.2011, me objekt: “*Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin gjyqësor civil të formës së prerë, datë 01.11.2010, të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës*”. Subjekti i rivlerësimit pretendon se është i pavërtetë konkluzioni i Komisionit, se në kohën e gjykimit të kësaj çështjeje ka pasur detyrime të pashlyera ndaj shoqërisë “{***}” ShPK.

22.2/a. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i dhënë prej tij është vendim për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit referuar parashikimeve të nenit 510 e vijues të K. Pr. Civile, për një vendim gjyqësor të formës së prerë, që përbën titull ekzekutiv dhe përmban detyrime për t’u ekzekutuar. Sipas subjektit, vendimi për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit nuk zgjidh çështje në themel, por merret vetëm me verifikimin e kushteve formale, që janë ekzistenca e një vendimi që zgjidh mosmarrëveshjen në themel, si dhe faktin që ky vendim është ose jo i formës së prerë. Në këto kushte,

¹⁷ Vendimet e Kolegjit nr. 9/2020 (JR), datë 26.6.2020; nr. 16/2020 (JR), datë 13.7.2020; nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020.

gjykimi për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit nuk është një gjykim që i nënshtrohet parimeve të përgjithshme të K. Pr. Civile, pasi me anë të tij vihet në ekzekutim një titull ekzekutiv, i cili në rastin konkret ka qenë vendim gjykate. Subjekti pretendon se nuk ka asnjë konflikt interesi, pasi nuk jemi përpara gjykimit të një mosmarrëveshjeje themeli, ku gjyqtari duhet të garantojë paanësinë e tij nga palët në proces, në rastin konkret jemi para një gjykimi të karakterit formal dhe të palidhur me palët e titullit ekzekutiv.

22.2/b. Subjekti pretendon se në dhënien e këtij vendimi nuk ka pasur shkak për arsye njëanshmërie, sepse vendimi gjyqësor kishte marrë formë të prerë dhe ky lloj vendimi nuk kërkon që gjykata të zgjidhë një konflikt, por t'i japë rrugë një faze tjetër dhe nuk ka alternativë vendimi për mospranim të ekzekutimit. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji që, duke marrë në konsideratë që kjo çështje i është caktuar atij me short, si dhe faktin që në çdo rast vendimmarrja do të ishte e njëjtë me atë të vendimit të dhënë prej tij, ta konsiderojë të padrejtë dhe të pabazuar në ligj qëndrimin e Komisionit.

22.3. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë:

22.3/a. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës¹⁸ ka informuar Komisionin se subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar çështjen gjyqësore me kërkues “{***}” ShPK, me objekt “Lëshimin e urdhrit të ekzekutimit”, për vendimin nr. {***}. Me vendimin datë 25.07.2011, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuesit “{***}” ShPK.

22.3/b. Nga verifikimi i vendimit gjyqësor të vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, rezulton se objekt gjykimi i çështjes së themelit, për të cilën është kërkuar lëshimi i urdhrit të ekzekutimit nga shoqëria “{***}” ShPK, është: *“Detyrimi i të paditurve të përmbushin detyrimin kontraktor, duke mundur lidhjen e kontratës së shkëmbimit të truallit për pasuritë e paluajtshme nr. {***}, nr. {***} etj.”*. Referuar listës së pasurive objekt gjykimi, rezulton se ato ndodhen në të njëjtën godinë me apartamentin e blerë nga subjekti pranë shoqërisë “{***}” ShPK. Pra, sikurse konstatohet çështja gjyqësore e themelit, për të cilën gjyqtari Shpëtim Reka ka dhënë më pas vendimin për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, ka qenë për një konflikt gjyqësor që pronarët e truallit kishin me shoqërinë “{***}” ShPK, pikërisht për godinën në të cilën ndodhej apartamenti i blerë nga subjekti i rivlerësimit, ku fillimisht kishte lidhur kontratën e porosisë në vitin 2005 dhe më pas kontratën e shitjes, datë 18.11.2011, me shoqërinë “{***}” ShPK.

22.4. Lidhur me pretendimin e subjektit, se në kohën e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, ai nuk ka pasur detyrim të pashlyer ndaj shoqërisë “{***}” ShPK, trupi gjykues vlerëson se, edhe nëse ky fakt do të rezultonte i provuar, subjekti i rivlerësimit do të gjendej sërish në të njëjtën situatë, për shkak të një marrëdhënieje interesi pasuror ende të pafinalizuar me palën kërkuese, për aq kohë sa kontrata përfundimtare e shitjes me këtë shoqëri është lidhur në datën 18.11.2011, pra pas datës së dhënies së vendimit për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit.

22.5. Me qëllim identifikimin e saktë të normës që rregullon këto marrëdhënie juridike, trupi gjykues vëren se ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, neni 3.1, parashikon se: *“Konflikti i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike”*. Në kuptim të parashikimit ligjor të mësipërm,

¹⁸ Shkresë nr. {***} prot., datë 02.11.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të cilën subjekti i rivlerësimit e ka paraqitur në përgjigje të pyetësorit datë 25.10.2021.

trupi gjykues çmon se duhet të analizojë nëse në vendimmarrjen e subjektit gjenden dy elemente thelbësore: 1. Interesi privat i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i subjektit; 2. Ndikimi i tij në mënyrë të padrejtë në kryerjen e detyrës.

22.5/a. Në analizë të dokumentacionit pronësor, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, rezulton se në vërtetimin hipotekor nr. {***}, datë 29.06.2007, apartamenti i blerë prej subjektit ka qenë i regjistruar në emër të shoqërisë “{***}” ShPK, pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Durrës, me regjistrim të përkohshëm. Në seksionin “*barrë mbi pasurinë*” të këtij vërtetimi evidentohet shënimi: “*Të mos kryhen veprime pa realizuar kontratën e këmbimit. U realizua kontrata e këmbimit*”. Bazuar në ligjin nr. 7843, datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” (ligji i kohës kur janë kryer veprimet hipotekore), në nenin 45 të tij, përcaktohet se: “*Sa kohë që një kufizim mbetet i regjistruar, nuk duhet të regjistrohet asnjë dokument që nuk pajtohet me të, pa urdhrin e regjistruesit ose vendimin e gjykatës*”.

22.5/b. Nga sa më lart mund të vlerësojmë se, në kushtet e vendosjes së urdhrit të kufizimit mbi apartamentin e blerë nga subjekti, ky i fundit do ta kishte të pamundur përfundimin e regjistrimit fillestar të pasurisë dhe pajisjen me certifikatë pronësie për këtë apartament, pa u zgjidhur paraprakisht marrëdhënia mes investitorit dhe pronarëve të truallit, përmes nënshkrimit të kontratave përfundimtare të shkëmbimit. Për rrjedhojë, lëshimi i urdhrit të ekzekutimit për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe zgjidhja e marrëdhënies së pronarëve të truallit me shoqërinë ndërtuese vlerësohet nga trupi gjykues si një veprim në mbështetje të interesave pasurorë të vetë subjektit të rivlerësimit, me qëllim pajisjen e tij me dokumentacion pronësie për apartamentin e blerë nga “{***}” ShPK. Ky vlerësim bazohet në faktin që, vetëm pak muaj pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, në datën 25.07.2011, subjekti në datën 18.11.2011 ka lidhur kontratën përfundimtare të shitjes me shoqërinë “{***}” ShPK, si dhe është pajisur me certifikatë pronësie për këtë apartament.

22.5/c. Për më tepër, nga analizimi i dokumentacionit që ndodhet në dosje, ka rezultuar se gjyqtari Shpëtim Reka ka pasur një marrëdhënie juridike pasurore me shoqërinë “{***}” ShPK, që në vitin 2004, kur ai ka porositur nga kjo shoqëri ndërtimin e një apartamenti banimi. Në interpretim të kësaj kontrate dhe kushteve të saj, kuptohet se marrëdhënia e palëve në lidhje me objektin e kontratës nuk ka përfunduar me nënshkrimin e saj. Pas likuidimit të çmimit të objektit të kontratës, përfundimit të ndërtimit dhe regjistrimit në regjistrat publikë të pronës objekt kontrate, palët kontraktore kishin detyrimin ligjor të lidhnin kontratën e shitjes së kësaj pasurie, me qëllim regjistrimin e saj në emër të blerësit, në mënyrë që ky i fundit të kishte të drejtën ta dispononte pronën ligjërisht. Fakti që marrëdhënia e subjektit me shoqërinë nuk ishte konkluduar me kontratën përfundimtare të shitjes së pasurinë edhe gjatë vitit 2011, kohë kur subjekti ka gjykuar kërkesën e shoqërisë “{***}” ShPK për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit, në kuptim të nenin 5 të ligjit nr. 9367, i ndryshuar, kjo marrëdhënie juridike civile me karakter pasuror përbën interes privat të zyrtarit/gjyqtarit. Duke pasur parasysh marrëdhënien e drejtpërdrejtë juridiko-civile me karakter pasuror, të shoqërisë mes zyrtarit/gjyqtarit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, e trajtuar në raport me përcaktimet e ligjit nr. 9367/2005¹⁹, i ndryshuar, trupi gjykues vlerëson se në rastin konkret zyrtari/gjyqtar ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit në këtë vendimmarrje gjyqësore, pasi edhe marrëdhënia kontraktore mes subjektit dhe palës ndërgjyqëse, shoqërisë “{***}” ShPK, nuk kishte përfunduar.

¹⁹ “[...] a) “Konflikt faktik i interesit” është gjendja, në të cilën interesat private të zyrtarit ndikojnë, kanë ndikuar ose mund të kenë ndikuar në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij zyrtare [...]”.

22.5/ç. Në lidhje me elementin e dytë, atë të ndikimit të vendimmarrjes së gjyqtarit në mënyrë të padrejtë të detyrës së tij publike, analizuar në raport me pretendimin e subjektit, se vendimi i dhënë prej tij nuk gjykon mosmarrëveshjet mes palëve, por është një veprim administrativ, trupi gjykues konstaton se neni 72, pika 1 dhe 6 të Kodit të Procedurës Civile, përcakton “rastet e përjashtimit të gjyqtarit”, ku parashikohet se: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me atë në gjykim”, “në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”. Trupi gjykues çmon se kjo dispozitë ligjore nuk përcakton natyrën e çështjes gjyqësore nga e cila gjyqtari duhet të heqë dorë nga gjykimi, në rastet kur vërtetohen rrethanat e përcaktuara në këtë nen, të cilat mund të shfaqin arsye serioze njëanshmërie. Si pasojë, gjykimet e një natyre të posaçme, si ato të “lëshimit të urdhrit të ekzekutimit”, nuk e përjashtojnë gjyqtarin nga detyrimi për të zbatuar përcaktimet e nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile.

22.5/d. Në analizë të parashikimeve ligjore të mësipërme, trupi gjykues vlerëson se nuk është e nevojshme të provohet nëse veprimi apo pasoja ka ardhur, por mjafton vetëm “mundësia” e veprimit kundër parimit të paanësisë dhe të objektivitetit në përputhje me përgjegjësinë e gjyqtarëve, që dhe në jetën e përditshme të jenë të vëmendshëm për të mos cenuar autoritetin e pushtetit gjyqësor e besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, si dhe me detyrimin e tyre që veprimet jashtëgjyqësore të jenë të atilla që të mos hedhin dyshime të arsyeshme për paanësinë e tyre, të ulin autoritetin e pushtetit gjyqësor ose të ndërhyjnë në kryerjen e detyrave gjyqësore.²⁰

22.5/dh. Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se kjo situatë e subjektit të rivlerësimit do të konsiderohet si pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me pasuritë e deklaruar nga djali, E. R.

23. Për pasurinë “apartament me sip. 51 m²”, ndodhur në lagjen nr. {***}, Durrës, djali i subjektit, E. R., në deklaratën e pasurisë vetting, ka deklaruar se kjo pasuri është fituar prej tij me anë të Dëshmisë së trashëgimisë testamentare të testamentlënës V. A. (gjyshja nga nëna), më datë 11.05.2016. Dëshmia e trashëgimisë me nr. {***} rep., nr. {***} kol. Testamenti i regjistruar me nr. regj. {***}, datë 31.07.2008. Ky apartament është regjistruar në emrin e tij sipas certifikatës së pronësisë, datë 01.06.2016, me nr. pasurie {***}.

23.1. Komisioni ka arritur në përfundimin se pasuria “apartament” afektohet në ligjshmërinë e burimeve të krijimit të saj për shkak të defektit të mungesës së burimeve të ligjshme, duke e vlerësuar të konsiderojë peshën e këtij defekti në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së djalit të subjektit, në përfundim të kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij.

23.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se këtë pasuri, djali i tij e ka përfitur me anë të testamentit të lënë nga nëna e bashkëshortes së tij, V. A. Referuar pikës 14, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, trashëgimia testamentare nuk mund të konsiderohet lidhje interesi, për rrjedhojë, sipas tij është e paarsyeshme që nëna e bashkëshortes së tij të konsiderohet person tjetër i lidhur.

23.2/a. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka pasur detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të trashëgimlënës testamentare (nëna e bashkëshortes), për shkak të

²⁰ Parimet e Bangalores, miratuar nga Kombet e Bashkuara me rezolutën 2006/23, komentet nr. 111-114: http://www.unodc.org/pdf/crime/corruption/judicial_group/Bangalore_principles.pdf dhe rregullat e Kodit të Etikës, miratuar nga Konferenca Gjyqësore Kombëtare, më datë 08.12.2006: http://www.gjykataelarte.gov.al/web/kodi_i_etikes_gjyqesore_1754.pdf

pamundësisë objektive për të siguruar dokumente të plota, që justifikojnë burimet e ligjshme të financimit të pasurisë “apartament në plazhin e Durrësit”. Pavarësisht këtij fakti, subjekti pretendon se me aktet e paraqitura ka provuar se nëna e bashkëshortes ka përfituar qira dhe të ardhura nga shitja e pasurisë në Francë, si dhe ka argumentuar se ka një situatë të kënaqshme financiare.

23.2/b. Subjekti kërkon nga Kolegji që konstatimet e Komisionit në lidhje me këtë pasuri të mos vlerësohen në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së djalit apo në drejtim të tij si subjekt, në kriterin e pasurisë apo në vendimmarrje në të gjitha elementet e saj.

23.3. Nga analizimi i dokumentacionit²¹ të ndodhur në dosjen e përcjellë nga Komisioni, lidhur me këtë pasuri, trupi gjykues konstaton se:

23.3/a. Nëna e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, V. A., e ka blerë këtë apartament më datë 05.06.2008, përmes kontratës së shitjes nr. {***}, lidhur me shoqërinë “{***}” ShPK. Çmimi i blerjes së apartamentit nga znj. A. rezulton në vlerën 3.450.000 lekë dhe, sipas përcaktimeve të kontratës së shitjes, kjo shumë është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. Në datën 10.06.2008, blerësja A. ka aplikuar në ASHK Durrës për regjistrimin e apartamentit në emër të saj, i cili rezulton të jetë regjistruar në datën 16.06.2008.

23.3/b. Në datën 31.07.2008, gati një muaj nga regjistrimi i kësaj pasurie në ASHK, nëna e bashkëshortes së subjektit, znj. V. A., me testament nr. {***} regj., i ka lënë djalit të subjektit të rivlerësimit këtë apartament. Pas vdekjes së saj, në datën 25.05.2015, djali i subjektit, z. E. R., ka kërkuar lëshimin e “Dëshmisë së trashëgimisë testamentare dhe ligjore” për trashëgimlënësen, bazuar në procesverbalin noterial nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 11.05.2016.

Në datën 11.05.2016, notere M. N. ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë testamentare dhe ligjore nr. {***}, për trashëgimlënësen V. A., duke përcaktuar si trashëgimtar të vetëm testamentar z. E. R. – nipin e saj, i cili trashëgoi apartamentin me sip. 51 m,² me nr. pasurie {***}, regjistruar në ZVRPP Durrës në datën 31.08.2008.

23.3/ç. Lidhur me pasurinë e fituar nga djali i tij nëpërmjet testamentit dhe të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e saj, në përgjigje të pyetësorit datë 25.10.2021, subjekti ka deklaruar:

“Fakti që nëna e bashkëshortes, V. A., ka lënë testament në lidhje me këtë pasuri, dëshmon një nga të drejtat e ligjshme të çdo shtetasi për të disponuar pasurinë me testament. ...mendoj se edhe vetë data e përpilimit të testamentit të dytë prej saj, data 31 korrik, që përkon me datën e lindjes së djalit E. R., shpreh qartë se ajo ka dashur t’i bëjë nipit E. R., jo vetëm një testament, por më tepër një dhuratë në ditën e lindjes së tij, sikurse ka vepruar edhe me fëmijët e tjerë të familjes, në forma të ndryshme. Nëna e bashkëshortes, aktualisht ka ndërruar jetë dhe ne nuk mund të dimë saktësisht dëshirat e saj, apo: “cila ka qenë arsyeja e blerjes së një pasurie të paluajtshme në qytetin e Durrësit në moshën 76 vjeç, ndërkohë që ishte me banim në Tiranë”, por di të them se këtë apartament ajo e shfrytëzoi për të pushuar gjatë periudhës së verës deri në gjallinë e saj. Apartamenti në fjalë nuk është përdorur dhe as përdoret nga djali dhe as nga pjesëtarë të tjerë të familjes time... Gjithashtu dua të shpjegoj se nëna e bashkëshortes, V. S. A. (N.) ka lindur në Lion të Francës në vitin 1932, gjatë kohës që familja e saj ka qenë në emigracion, ajo së bashku me trashëgimtarët e tjerë kanë trashëguar nga i ati, S. N., një pasuri me vendndodhje në Desinë, Lion, Francë, e cila u ka siguruar të ardhura qiraje për vite të tëra, deri në momentin e shitjes (pas vitit 1998). Nga shënimet apo

²¹ Shkresë “Kthim përgjigje”, e ASHK-së Durrës, nr.{***} prot., datë 11.06.2020; Shkresë “Kthim përgjigje” e ASHK-së Durrës nr. {***} prot., datë 06.01.2021.

kujtimet e shkruara prej njerëzve që i kanë njohur nga afër, kemi mësuar se shtëpitë e gjyshit të bashkëshortes z. S. N., në Desinë të Lionit, në Francë, kanë qenë: a) shtëpia e madhe me dy kate dhe katërmbëdhjetë dhoma, me disa kuzhina, banja e korridore; b) shtëpia e mesit, e vjetër, ku kati i parë ka qenë lavanteri dhe dushet (banja publike) të qytetit të Desinës; dhe c) shtëpia e vogël... (shënime të nxjerra nga artikuj të botuar nga z. A. K. dhe z. S. L., kopje të të cilëve po jua vë në dispozicion). Me sa kam dijeni, këto prona janë shitur pas vitit 1998 dhe përpara vitit 2000, për rrjedhojë nëna e bashkëshortes, V. A., si trashëgimtare ka përfiturar të ardhura. Nuk kemi asnjë dokument që lidhet me shitjen apo shumat e përfituara prej saj, sepse në atë kohë bashkëshortja nuk ishte ende trashëgimtare ligjore e prindërve”.

23.3./d. Lidhur me faktin se nuk ka qenë vetëm djali i tij, E. R., që ka përfiturar nga pasuria e gjyshes së tij, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision deklarata noteriale²² të nënshkruara nga mbesat e znj. V. A., të cilat shprehen lidhur me dhuratat e ndryshme që kanë marrë nga gjyshja e tyre, nëpërmjet të cilave subjekti kërkon të provojë se znj. V. A. gjatë jetës së saj i ka trajtuar nipat dhe mbesat në mënyrë të barabartë.

23.4. Komisioni, pasi ka konstatuar se ky apartament është blerë në vitin 2008 nga nëna e bashkëshortes së subjektit, gjatë periudhës që subjekti dhe bashkëshortja kanë kryer detyrën e gjyqtarit dhe prokurores, duke marrë në konsideratë faktin se ky apartament, gati një muaj pas blerjes dhe regjistrimit nga e ndjera V. A., i është lënë me testament djalit të subjektit, duke përjashtuar nga trashëgimia fëmijët e saj, ka kryer një hetim të plotë në lidhje me aftësinë financiare të kësaj shtetaseje bazuar në dyshimin e arsyeshëm se kemi të bëjmë me një pasuri të fshehur të subjektit.

23.4/a. Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me këtë apartament, Komisioni ka konstatuar se: (i) Znj. V. A. nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pasurisë “apartament”. (ii) Znj. V. A. e ka blerë këtë apartament në datën 05.06.2008 dhe në datën 31.07.2008 ka përpiluar testament, në favor të nipit të saj, E. R., një muaj pas blerjes së apartamentit, duke përjashtuar nga trashëgimia të gjithë trashëgimtarët e saj ligjorë. (iii) Znj. V. A. ka banuar vazhdimisht në Tiranë, si dhe ka qenë në moshën 76-vjeçare në kohën e blerjes së apartamentit, duke mbetur e paqartë arsyeja e investimit në një pasuri të paluajtshme në qytetin e Durrësit. (iv) Subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij jetojnë në Durrës. (v) Sipas dokumentacionit të administruar nga FSHU-ja, rezulton se në këtë apartament ka pasur konsum energjie nga muaji shtator 2020 e në vijim, pra pasi znj. A. ka ndërruar jetë, për rrjedhojë, deklarimi i subjektit se znj. A. e ka shfrytëzuar këtë apartament për të pushuar në muajt e verës nuk qëndron. (vi) Subjekti ka gjykuar disa çështje, ku palë ka qenë shoqëria “{***}” ShPK, në periudhën nga viti 2011 e në vijim, dhe nga shqyrtimi i të cilave rezulton që vendimmarrja e subjektit të ketë qenë në çdo rast në favor të shoqërisë “{***}” ShPK apo administratorit/ortakut të saj.

(vii) Subjekti ka udhëtuar së bashku me administratorin e shoqërisë “{***}” ShPK, z. R. K., me automjetet në pronësi të z. {***}, pavarësisht se e kishte palë në gjykim.

23.5. Në vlerësim të shkaqeve të ankimit të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues fillimisht vlerësoi të analizojë statusin ligjor të nënës së bashkëshortes së subjektit, nëse ajo konsiderohet person i lidhur

²² Deklaratë noteriale e znj. M. (I.) K., datë 13.01.2022 (e përkthyer në shqip); Deklaratë noteriale e znj. E. I., datë 13.01.2022 (e përkthyer në shqip); Deklaratë noteriale e znj. E. Xh., e datës 10.02.2022; Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.09.2016; Kontrate shitje pasuri e paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.12.2021; Kontratë shitje pasuri e paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.12.2021.

apo person tjetër i lidhur për subjektin e rivlerësimit dhe se deri në çfarë kufijsh ekzistonte detyrimi i subjektit të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e pasurisë së saj.

Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, vetëm në ankimin e paraqitur në Kolegj, ka paraqitur pretendime lidhur me përjashtimin e kësaj marrëdhënieje nga grupi i atyre të specifikuara në nenin 32 pika 4, për detyrimin e tij për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, ndërsa gjatë hetimit administrativ në Komision ka paraqitur dokumentacion dhe argumente për justifikimin e burimeve të krijimit të pasurisë.

23.5/a. Për sa i përket konsiderimit ose jo të nënës së bashkëshortes së subjektit si person tjetër i lidhur, në kuptim të përkufizimit për “persona të tjerë të lidhur”, të dhënë nga neni 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016, që personi tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit të konsiderohet i tillë, duhet të provohet një lidhje interesi mes tyre, që vjen si pasojë: i) e një interesi pasuror; ose ii) e çdo marrëdhënieje tjetër biznesi. Në këtë dispozitë parashikohet rrethi i personave të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, në funksion të përcaktimit të detyrimit të subjekteve të rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të tyre, kur këta persona të tjerë të lidhur të kenë si elemente të detyrueshme në marrëdhënien me subjektin e rivlerësimit, një marrëdhënie huaje apo dhurimi, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e po këtij ligji. Në kuptim të kësaj dispozite, një subjekt rivlerësimi do të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur, vetëm kur ka hyrë me këtë të fundit në një marrëdhënie huaje ose dhurimi. Në rastin konkret rezulton se interesi pasuror që djali i subjektit të rivlerësimit ka pasur/përfituar nga gjyshja e tij, pas vdekjes së saj në vitin 2015, është sipas trashëgimisë testamentare.

23.5/b. Në nenin 372 të Kodit Civil, “Kuptimi i testamentit”, parashikohet se: *“Testamenti është një veprim juridik i njëanshëm, i kryer nga vetë trashëgimlënësi, me anë të të cilit ky disponon pasurinë e tij për kohën pas vdekjes. Testamenti nuk mund të bëhet prej dy ose më shumë personave po në një akt, as edhe në dobi të një të treti, as me disponime reciproke”*. Ndërsa në nenin 377, “Caktimi i trashëgimtarit”, parashikohet se: *“Trashëgimlënësi që nuk lë të paslindur ose të paralindur, ose vëllezër apo motra, ka të drejtë të disponojë me testament pasurinë e vet, në favor të çdo personi fizik apo juridik”*. Në kuptim të dispozitave të mësipërme ka qenë vullneti i lirë i testamentares V. A. për të disponuar lirisht pasurinë e saj në favor të nipit E. R. (djalit të subjektit të rivlerësimit). Sikurse vërehet, nuk gjendemi para një marrëdhënie huaje apo dhurimi sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, në mënyrë që nëna e bashkëshortes së subjektit të kualifikohet si person tjetër i lidhur.

23.5/c. Trupi gjykues, në referim të pikës 11,²³ të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, pikës 1,²⁴ të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në kushtet kur: (i) Komisioni ka konstatuar mungesën e burimeve të ligjshme të nënës së bashkëshortes së subjektit për krijimin e kësaj pasurie; (ii) subjekti ka gjykuar disa çështje ku palë ka qenë shoqëria “{***}” SHPK, në periudhën nga viti 2011 e në vijim (shoqëri që ka ndërtuar objektin ku ndodhet apartamenti i djalit të subjektit); (iii) janë ngritur dyshime për pasuri të fshehur të subjektit, vlerëson se subjekti ka pasur detyrimin për të justifikuar burimin e krijimit të kësaj pasurie, për të shmangur në këtë mënyrë çdo paqartësi të evidentuar nga Komisioni.

²³ “Pasuri” janë të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2013, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, që janë në pronësi, posedim ose në përdorim të subjektit të rivlerësimit.

²⁴ Subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojnë ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur.

23.6. Në analizë të pretendimeve të subjektit, në raport me situatën faktike të cituar më sipër dhe legjislacionin e zbatueshëm, trupi gjykues, nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, kreu verifikimet mbi mundësinë financiare të nënës së bashkëshortes, znj. V. A., për blerjen e apartamentit, të cilin më pas, nëpërmjet testamentit, ia kaloi djalit të subjektit të rivlerësimit, E. R.

23.6/a. Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti i rivlerësimit²⁵ në Komision, për të vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të nënës së bashkëshortes së tij për blerjen e apartamentit, rezulton se provohet fakti se znj. V. A. ka pasur pasuri në shtetin francez, trashëguar nga babai i saj, z. S. N. dhe mund të ketë përfituar të ardhura nga qiradhënia dhe shitja e saj, por subjekti nuk arriti të paraqiste dokumentacion justifikues ligjor lidhur me përfitimin dhe masën e shumës së përfituar nga nëna e bashkëshortes së tij, për të ardhurat nga shitja e pronës në Francë, të cilat, sipas subjektit, kanë shërbyer si burim krijimi për pasurinë “apartament”, lënë me testament djalit të tij, si dhe nuk ka dokumentuar pagimin e detyrimeve tatimore për këto të ardhura. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer në Kolegj, rezultoi se ashtu si në Komision, nëna e bashkëshortes së subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 4.392.334,22 lekë, për blerjen e apartamentit, të cilin ia dhuroi më pas djalit të subjektit të rivlerësimit.

23.7. Lidhur me pretendimin e subjektit, se ndodhet në pamundësi objektive për të siguruar dokumente²⁶ të plota që justifikojnë burimet e ligjshme të krijimit të pasurisë “apartament” nga nëna e bashkëshortes, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit e ka pasur të gjithë kohën e mjaftueshme për të mbledhur informacionin/dokumentacionin për këtë pasuri, të deklaruar në deklaratën e pasurisë vetting. Ky vlerësim bazohet edhe në pikën 7 të Udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, i cili përcakton se: *“Për çdo pasuri në pronësi, të paluajtshme, të luajtshme, likuiditete, vlerën e aksioneve, letrave me vlerë dhe pjesët e kapitalit në zotërim etj., subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të duhet të deklarojë burimin, në momentin e krijimit për secilën prej tyre, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit për secilën pasuri, në momentin e fitimit të tyre”*.

23.8. Për sa më lart, trupi gjykues do të vlerësojë peshën e kësaj situate të subjektit të rivlerësimit në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, që lidhet me të gjitha rrethanat e çështjes dhe do të

²⁵ Për të vërtetuar sqarimet e dhëna në përgjigje të pyetësorit datë 25.10.2021, subjekti ka paraqitur: Shkresë nr. {***} prot., datë 23.08.2019, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, përmes së cilës vërtetohen të ardhurat nga pensioni i pleqërisë së V. A., për periudhën 01.01.1995 – 25.05.2015; Certifikatë vdekjeje e znj. V. A. dhe Dëshmi trashëgimie nr. {***}, datë 22.03.1994, për trashëgimlënësin S. N., ku nëna e bashkëshortes së subjektit, V. A., është përcaktuar si trashëgimtare e ¼ pjesë të pasurisë trashëgimore; Prokurë e posaçme nr. {***} rep. dhe nr. {***} kol., datë 25.03.1994, me anë të së cilës, trashëgimtarët e S. N., ndërmjet të cilëve edhe nëna e bashkëshortes së subjektit, V. A., kanë autorizuar z. C. Dh., banues në Francë, për të kryer të gjitha veprimet për shitjen e shtëpisë që kanë pasur trashëgim nga i ati, S. N., e cila ndodhet në adresën {***} {***}-Decines-Rhone, e ndërtuar mbi truallin e blerë më 20 dhjetor 1927, nga i ndjeri S. N.; Pasqyrë e llogarive për pagesat e qirave për periudhën 01.01.1998 deri më 04.06.1998; Pasqyrë e administratorit të ndërtesave për ndërtesën {***}, {***}, {***} Decines, e titulluar “Historiku i qiraxhinjve për periudhën nga 01.01.1998 në 04.06.1998”; Korrespondencë e datës 18.02.1998, e z. K. N. (trashëgimtar i S. N.), me noterin z. C., nëpërmjet së cilës njoftohet dërgimi i dokumentacionit të nevojshëm për shitjen e pronës së S. N. në Desinë; Korrespondencë e datës 08.10.1998, e z. K. N. (trashëgimtar i S. N.) me z. C. S. M., nëpërmjet së cilës i kërkon të merren masat për të dorëzuar shumat e qirasë së vitit 1996 te përfaqësuesi i trashëgimtarëve, z. C. Dh.; Korrespondencë e datës 23 tetor 1998, e administratorit të pasurive, zotit C. S. M., drejtuar zotit K. N., në lidhje me certifikatat e trashëgimtarëve; Korrespondencë, e datës 3 nëntor 1998, e z. K. N. (trashëgimtar i S. N.), me noterin dhe zotit C. Dh., në lidhje me njoftimin se Zoti C. Dh. është ngarkuar të përfaqësojë interesat e trashëgimtarëve të zotit N., për zgjidhjen e çështjes në interes të tyre.

²⁶ Në mbështetje të pretendimit të tij, subjekti ka paraqitur informacionin e përcjellë nga Raiffeisen Bank, datë 29.10.2018, ku pasqyrohet fakti se znj. V. A. ka qenë kliente e bankës dhe ka pasur dy llogari së bashku me djalin e saj, D. A., kjo llogari është çelur nga ish-Banka e Kursimeve ShA, por për shkak se banka nuk ka qenë e informatizuar, është e pamundur të vihet në dispozicion informacion.

konsiderohet si pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

23.9. Në analizimin e kësaj pasurie, Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar disa çështje, ku palë ka qenë shoqëria “{***}” ShPK, me të cilën nëna e bashkëshortes së tij ka lidhur kontratën e shitjes për blerjen e apartamentit me sip. 51 m², ndodhur në lagjen nr. {***}, Durrës. Subjekti ka udhëtuar së bashku me administratorin e shoqërisë “{***}” ShPK, z. R. K., me automjetet në pronësi të tij. Në çështjet e gjykuara nga subjekti, në periudhën nga viti 2011 e në vijim, ka rezultuar që vendimmarrja e subjektit të ketë qenë në çdo rast në favor të shoqërisë “{***}” ShPK apo administratorit/ortakut të saj.

23.9/a. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se blerja e apartamentit nga nëna e bashkëshortes së tij dhe i ashtuquajturi “konflikt interesi” nuk ekzistojnë në të njëjtën kohë dhe as nuk janë të lidhura në logjikën që parashtron Komisioni, trupi gjykues konstaton se nëna e bashkëshortes së tij, znj. V. A., e ka blerë apartamentin nga shoqëria “{***}” ShPK në datën 05.06.2008, ndërsa gjykimet e zhvilluara prej tij me palë ndërgjyqëse këtë shoqëri, datojnë nga viti 2011 e në vijim, pra ka një distancë kohore rreth trevjeçare, nga momenti i blerjes së apartamentit nga kjo shoqëri e deri në gjykimet e çështjeve gjyqësore të subjektit me palë shoqërinë “{***}” ShPK. Në kushtet ku marrëdhënia kontraktuale midis nënës së bashkëshortes së tij me shoqërinë “{***}” ShPK kishte përfunduar disa vite para se subjekti të fillonte të gjykonte çështje gjyqësore me palë këtë shoqëri, trupi gjykues nuk evidenton ndonjë rrethanë që të mund të ndikonte në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësi të tij zyrtare, për rrjedhojë, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk gjendej në kushtet e konfliktit të interesit apo në një nga rastet e parashikuara nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile. Megjithatë, marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me shoqërinë “{***}” ShPK dhe administratorin e saj, z. R. K., trupi gjykues e ka analizuar gjerësisht në paragrafin 27 të këtij vendimi.

24. Lidhur me të ardhurat e përfituara ndër vite, nga qiradhënia e apartamentit të ndodhur në rrugën “{*}”, Tiranë, me sip. 70.7 m²**

24.1. Komisioni ka arritur në përfundimin se për të ardhurat e përfituara nga qiramarrja, për periudhën shtator 2000 – shtator 2001, me vlerë qiraje mujore 350 USD, subjekti nuk ka mundur të provojë të ardhurat e përfituara nga kjo kontratë qiraje, si dhe pagesën e detyrimeve tatimore. Ndërsa për të ardhurat e përfituara për periudhën janar 2006 – 31 dhjetor 2011, me vlerë qiraje mujore 30.000 lekë, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues mbi pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara, si dhe nuk ka paraqitur kontratat e qiradhënies për periudhën 2008 – 2011. Për pasojë, të ardhurat e pretenduara nga kjo qiradhënie nuk janë përfshirë në analizën financiare përfundimtare.

24.2. Subjekti i rivlerësimit i konsideron të pabazuara në prova dhe në ligj konkluzionet e Komisionit lidhur me moskonsiderimin e të ardhurave nga qiratë, kur ato provohen se janë përfitur nga bashkëshortja e tij (personi i lidhur si qiradhënës) dhe legjislacioni tatimor nuk e identifikon si subjekt që ka pasur detyrimin për pagimin e tatimeve. Konkretisht, subjekti kërkon nga Kolegji:

(i) Përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave nga qiraja, të përfitur nga kontrata e qirasë me shtetasin italian F. L. (në atë kohë, Drejtor i agjencisë së reklamave “{***}”²⁷), për periudhën shtator

²⁷ Subjekti, për të provuar pretendimet e tij, ka depozituar deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.07.2021, të qiramarrësit, z. F. L.

2000 – shtator 2001, si dhe të ardhurat nga qiraja për periudhën 2006 – 2011, me qiramarrës shtetasin A. F., i regjistruar si “person fizik”. Këto marrëdhënie qiraje janë deklaruar si në DPV-në e vitit 2003, ashtu edhe në deklaratën *vetting*.

(ii) Detyrimi i pagesës së tatimit mbi qiranë ka qenë i subjekteve qiramarrës “{***}”, i regjistruar në regjistrat publikë, me NIPT {***} dhe i personit fizik A. F., që ushtronin veprimtari tregtare.

(iii) Mungesa e gjetjes së të dhënave apo e mosmbajtjes së tyre nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, që është organi, i cili ka për detyrë të vjelë dhe të mbajë evidencat përkatëse për tatimet e paguara, e vendos atë në kushtet e pamundësisë objektive sipas nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe nuk duhet ta penalizojë atë si qiradhënës.

(iv) Kontrata me shtetasin F. L. është lidhur para miratimit të ligjit nr. 9049/2003, periudhë ku as subjekti, por edhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur detyrimin për deklarim të pasurisë, për rrjedhojë, subjekti pretendon se është i justifikuar ligjërisht për mosruajtjen e dokumentacionit provues të kësaj qiradhënie.

(iv) Në kushtet kur po merren në shqyrtim marrëdhëniet e qiradhënies prej personit të lidhur (bashkëshortes), e cila është subjekt deklarimi dhe madje është konfirmuar në detyrë nga një tjetër trup gjykues i Komisionit, subjekti kërkon nga Kolegji që për këtë çështje të konsiderojë analizën e bërë në vendimin e Komisionit që i përket subjektit të rivlerësimit F. R.

24.3. Lidhur me këtë shkak ankimi trupi gjykues mori në analizë dokumentacionin e administruar në Komision duke e ballafaquar atë me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit ndër vite, nga i cili rezulton se:

24.3/a. Në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie, në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit, në formularin A-5, rubrikën “Likuiditete”, në përshkrimin e llogarive bankare dhe likuiditetit *cash*, ka deklaruar të ardhurat nga puna e tij dhe të bashkëshortes, si dhe të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e banesës në emër të bashkëshortes. Subjekti në këtë deklarim nuk ka specifikuar shumën e përfituar nga kjo marrëdhënie qiraje apo vitin se kur është përfituar kjo e ardhur.

24.3/b. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit në rubrikën: “*Angazhime dhe veprimtari private/publike dhe të ardhura të krijuara prej tyre*”, ka deklaruar në mënyrë të hollësishme të ardhurat nga qiraja, duke specifikuar vitet, shumat e përfituara, si dhe pagesën e detyrimit tatimor, konkretisht: **1.** Për periudhën shtator 2000 – shtator 2001, përfituar 350 dollarë në muaj (-35 dollarë tatim), prill 2002 – prill 2003, përfituar 250 dollarë në muaj (-25 dollarë tatim), prill 2003 – prill 2004, përfituar 300 dollarë në muaj (-30 dollarë tatim), në total për këtë periudhë 9.720 (nëntë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) USD.

2. Për periudhën prill 2004 – dhjetor 2005, përfituar 35.000 lekë në muaj (-3.500 lekë tatim), për periudhën janar 2006 – dhjetor 2011, përfituar 30.000 lekë në muaj neto, janar 2012 – dhjetor 2014, përfituar 36.000 lekë në muaj neto, janar – shtator 2015, shuma 25.500 lekë/muaj neto, në total për këtë periudhë, subjekti ka deklaruar 4.290.000 lekë, ndërsa për periudhën shkurt – mars 2016 ka përfituar 300 euro në muaj, në total 600 (gjashtëqind) euro.

24.3/c. Për të vërtetuar qiradhënien dhe të ardhurat e ligjshme të krijuara nga marrëdhëniet e qirasë ndër vite të apartamentit me sip. 70.7 m,² të ndodhur në rrugën “{***}”, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *vetting*, pyetësorit standard, por edhe pyetësorit të datës 25.10.2021 dokumentet: (i) kopje të kontratave të qirasë; (ii) kopje të pagesave të kryera ndër vite për tatimin në burim të të ardhurave të përfituara nga qiradhënia e kësaj pasurie; (iii) kopje të transaksioneve të kryera në BKT, nga

subjektet qiramarrëse për pagesat e kryera prej tyre, si dhe (iv) shkresë nr. {***} prot., datë 28.06.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, e cila ka konfirmuar pjesërisht pagesat e tatimit në burim për kontratat e qirasë të lidhura nga bashkëshortja e subjektit, F. R.

Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezulton se bashkëshortja e subjektit ka lidhur kontrata qiraje me subjekte të ndryshme dhe Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të subjektit vetëm të ardhurat e këtyre kontratave të dokumentuara dhe për të cilat janë paguar tatimet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi.

24.4. Për shumat e pretenduara të përfituar nga qiraja për periudhën shtator 2000 – shtator 2001, me qiramarrës shtetasin italian F. L., me vlerë qiraje mujore 350 USD, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka depozituar kontratën e qirasë me këtë qiramarrës, si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion provues mbi pagesat e tyre apo pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga qiradhënia. Shkresa nr. {***} prot., datë 28.06.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me pagesat e kryera nga shtetasi italian F. L., në atë kohë Drejtor i agjencisë së reklamave “{***}”, me NIPT {***}, saktëson se nuk mund të identifikojë nëse janë kryer pagesa apo jo lidhur me tatimin në burim (tatim mbi qiranë).

24.4/a Lidhur me pretendimin e subjektit, se në atë periudhë nuk ka pasur detyrimin për deklarim të pasurisë dhe prandaj nuk mund të ruante dokumentacionin përkatës, trupi gjykues çmon se në kushtet kur subjekti ka arritur të dokumentojë pagesat e detyrimeve tatimore për të ardhurat nga qiratë për vitet e tjera, kjo rrethanë duket e pamjaftueshme për ta vendosur atë në kushtet e pamundësisë objektive, sipas përcaktimit të nenit 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për provimin e pagesës së tatimit në burim për të ardhurën nga qiraja, për periudhën e viteve 2000 – 2001. Ky konkluzion mbështetet edhe në faktin se bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim të vitit 2003, në rubrikën “Detyrime ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ka deklaruar: *“Detyrim ndaj degës së tatimeve për vlerën prej 10% të qirasë së banesës, shumën 30 USD në muaj”*.

24.4/b. Ndërsa për sa i përket deklaratës noteriale²⁸ nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 07.07.2021, të shtetasit z. F. L., të cilën subjekti e ka depozituar në Komision, por edhe bashkëlidhur ankimit në Kolegj, trupi gjykues çmon se ky akt i hartuar gjatë procesit të rivlerësimit ka një vlerë të kufizuar në provimin e fakteve të ndodhura vite më parë, dhe informacioni që përcjell deklarata është i pamjaftueshëm për të provuar pagesën e detyrimeve tatimore për këto të ardhura, me qëllim provimin e ligjshmërisë tyre.

24.4/c. Nga sa më lart, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit të ardhurat e përfituara nga qiraja, për periudhën shtator 2000 – shtator 2001.

24.5. Lidhur me shumat e pretenduara të përfituara nga qiraja për periudhën janar 2006 – dhjetor 2011, me vlerë qiraje mujore 30.000 lekë, me qiramarrës A. F., trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të ndodhur në fashikujt e Komisionit, konstaton se:

24.5/a. Në deklaratat e interesave periodikë të viteve 2006 – 2011, subjekti i rivlerësimit, në rubrikën *“Të ardhura nga angazhimet në veprimtari private dhe publike”*, ka deklaruar rregullisht të ardhurat nga dhënia me qira e apartamentit në Tiranë, në vlerën 360.000 (treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar në deklaratën vetting të njëjtat vlera për të ardhurat nga qiraja.

²⁸ Në këtë deklaratë, z. F. L. ka konfirmuar se ka zhvilluar aktivitet të regjistruar me emrin “{***}”, në apartamentin në pronësi të F. R. dhe ka paguar qiranë gjatë viteve 2000 – 2001 dhe çdo detyrim tjetër sipas dispozitave të qiramarrjes.

24.5/b. Në dosje gjenden: kontratë qiramarrje, e panënshkruar para një noteri, me afat 01.01.2006 – 01.01.2007, me vlerë mujore 30.000 lekë në muaj, dhe kontratë qiramarrje, e panënshkruar para një noteri, me afat 01.01.2007 – 01.01.2008, me vlerë mujore 30.000 lekë në muaj, me qiramarrës A. F. Në këto kontrata, mënyra e pagesës së tatim-fitimit mbi çmimin e qirasë parashikohet në pikën 5 të kontratës, ku citohet se: *“Tatimi i fitimit mbi çmimin e qirasë mujore do të paguhet çdo muaj në organet tatimore nga pala qiramarrëse dhe do të përballohet nga qiradhënësja”*.

24.5/c. Në lidhje me kontratën e qirasë, të lidhur me shtetasin A. F., në përgjigje të pyetësorit nr.1, datë 25.10.2021, subjekti deklaroi se: *“Me shtetasin A. F., marrëdhënia kontraktore ka filluar që në vitin 2006 deri në shtator 2015. Fakti që marrëdhënia kontraktore ka qenë permanente dhe e deklaruar për çdo vit, mendoj se nuk e vë në dyshim ekzistencën e marrëdhënies juridike të qiramarrjes edhe për katër vitet e ndërmjetme, 2008 – 2011, që kanë mungesë dokumentacioni”*.

24.5/ç. Lidhur me mungesën e kontratave të qirasë për katër vitet e ndërmjetme 2008 – 2011, në kushtet kur kjo marrëdhënie kontraktore me shtetasin A. F. ka qenë e vazhdueshme, e pandërprerë, janë deklaruar në mënyrë konsistente në deklaratat periodike vjetore të ardhurat e përfituara nga qiraja, si dhe referuar parashikimit të nenit 821²⁹ të Kodit Civil, kjo ripërtëritje mund të kryhet edhe pa pasur një kontratë fizike me shkrim, krijohet bindja se ka ekzistuar një marrëdhënie qiraje me këtë shtetas, pasi kjo marrëdhënie ka vazhduar edhe në vitet 2012 e në vijim.

24.5/d. Nga verifikimi i dokumentacionit, rezulton se shtetasi A. F. figuron i regjistruar si person fizik nga data 25.07.2008, në një kohë që marrëdhënia e qirasë ka filluar në vitin 2006, çka nuk e përjashton detyrimin e subjektit të paktën për vitet 2006 – 2008, për pagimin e detyrimeve tatimore referuar nenit 33, pika 1, germa “ë” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i cili parashikon detyrimin e subjektit qiramarrës, në rastet kur ai është person juridik, për të mbajtur dhe paguar tatimin në burim. Pavarësisht këtij fakti, në kushtet kur në nenin 5 të kontratës së qirasë të lidhur midis palëve, është përcaktuar se *tatimi i fitimit mbi çmimin e qirasë mujore do të përballohet nga qiradhënësja*, subjekti duhej të provonte pagesën e kryerjes së këtij detyrimi.

24.5/dh. Për sa i përket ligjshmërisë së të ardhurës të përfituar nga qiraja për periudhën 2006 – 2011, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues mbi pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga qiradhënia për periudhën 2006 – 2007 dhe 2008 – 2011, dhe nuk ka paraqitur kontratat e qiradhënies për periudhën 2008 – 2011. Bazuar në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore.

24.6. Lidhur me pretendimin e subjektit, se në kushtet kur të ardhurat nga qiraja janë përfituar nga pasuria e bashkëshortes së tij dhe ajo ka lidhur kontratat e qirasë me qiramarrësit, Kolegji duhet t’i referohet vendimit të Komisionit, që i përket konfirmimit në detyrë të F. R. si subjekt rivlerësimi, trupi gjykues çmon të theksojë se objekt shqyrtimi i Kolegjit është vendimi i Komisionit që i përket subjektit të rivlerësimit Shpëtim Reka. Megjithatë, nga një kontroll *prima facie* i vendimit nr. 518, datë 25.03.2022 të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit F. R. (bashkëshortes së subjektit), konstatohet se pretendimi i subjektit nuk qëndron. Komisioni në analizën e të ardhurave nga qiraja

²⁹ Përsëritja e kontratës së qirasë: *“Qiraja përtërihet në qoftë se, pasi të ketë mbaruar afati i saj, qiramarrësit i lihet në përdorim sendi i dhënë me qira pa kundërshtimin e qiradhënësit. Qiraja e re rregullohet me të njëjtat kushte si e mëparshmeja, por kohëzgjatja e saj caktohet si për qiratë me afat të caktuar”*.

për këtë pasuri, në vendimin që i përket bashkëshortes së tij, ka konstatuar problematika të njëjta me ato të identifikuar në rastin e subjektit Shpëtim Reka, konkretisht:

(i) Në paragrafin 12.13, faqja 32 e vendimit të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit F. R., lidhur me marrëdhënien e qirasë me shtetasin F. L., për periudhën 2000 – 2001, ka konkluduar se: *mbetet e paprovuar shuma e marrë, si dhe pagimi i detyrimeve tatimore, megjithëse trupi gjykues vlerëson si të besueshme deklaratimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej saj. Në vijim, kjo shumë nuk krijon problematika në analizën financiare për këtë periudhë.*

(ii) Lidhur me të ardhurat nga qiraja, për periudhën janar 2008 – dhjetor 2011, me qiramarrës A. F., në paragrafin 12.14, faqja 33 e vendimit të Komisionit, ky i fundit pranon faktin se kjo marrëdhënie mund të ketë ekzistuar dhe se të ardhurat nga qiratë kanë qenë likuiditete në dispozicion të familjes Reka, por edhe Komisioni nuk i ka përfshirë ato në analizën financiare, duke vlerësuar se nuk plotësojnë kërkesat e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

24.7. Në përfundim të analizimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar vetëm kushtin e parë, atë të deklaratimit të këtyre të ardhurave në deklaratat e interesave periodikë vjetorë dhe në deklaratën *vetting*, por nuk ka dorëzuar dokumentacion justifikues ligjor lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore për to, për rrjedhojë, vlerësohet i drejtë qëndrimi i Komisionit për të mos përfshirë në analizën financiare të subjektit të ardhurat nga qiraja, për periudhën 2006 – 2011.

25. Për pasurinë “automjet me targë: {***}”

25.1. Komisioni në vendim, pasi konstatoi parregullsinë e dokumentacionit, përmes të cilit subjekti ka fituar pronësinë e automjetit me targë: {***}, vlerësoi se veprimet e subjektit nuk janë në përputhje me etikën dhe sjelljen e duhur për një gjyqtar dhe duhen të jenë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016. Komisioni e ka analizuar këtë pasuri, pasi në deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie, në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar si burim krijimi për blerjen e automjetit tip “Mercedes - Benz”³⁰.

25.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konstatimet e Komisionit për parregullsi të dokumentacionit të blerjes së këtij automjeti i përkasin periudhës së vitit 1999, kohë kur ai dhe bashkëshortja e tij nuk ka qenë të orientuar me dokumentacionin e automjeteve, duke e lënë përpilimin e tyre në dorë të personave të tjerë. Për sa kohë automjeti është treguar pa probleme dhe nga verifikimet nuk rezulton as si automjet i vjedhur dhe as si automjet me detyrime doganore, subjekti kërkon nga Kolegji që kjo çështje të mos ndikojë në vlerësimin e tij në këtë proces, në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

25.3. Në përfundim të rezultateve të hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar se automjeti i regjistruar me këtë targë është i markës “Mercedes - Benz” dhe jo “Wolkswagen Golf”, siç është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit. (i) Në Librezën e automjetit, të konfirmuar edhe nga ana e subjektit, janë vendosur të dhëna jo të vërteta, bazuar në vetëdeklarimin e tij. (ii) Në këtë librezë është deklaruar që subjekti e ka blerë këtë automjet nga shtetasi W. W., ndërkohë ai në përgjigje të

³⁰ Në deklaratën para fillimit të detyrës, në vitin 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për blerjen automjetit tip “Mercedes - Benz”, në vlerën 2.500 USD, me burim të ardhurat nga punësimi dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit “Wolkswagen Golf”, me targë: {***}. Në DIPP-në e vitit 2005, subjekti ka deklaruar shitjen e automjetit tip “Mercedes - Benz”, në vlerën 10.000 euro.

pyetësorit të datës 11.11.2021 ka mohuar të ketë blerë automjetin nga ky shtetas. (iii) Dokumenti i regjistrimit të automjetit në gjuhën gjermane, në emrin e subjektit, mban datën 20.09.1999, ndërkohë ai pretendon se këtë automjet e ka blerë në dhjetor të vitit 1999. (iv) Ky automjet me kontratë shitje nr. {***}, datë 28.12.1999, është shitur nga ana e subjektit të rivlerësimit të bashkëshortja e tij, znj. F. R., për çmimin 500.000 lekë. (v) Në datën 10.01.2000, ky automjet, nëpërmjet dokumentit në gjuhën gjermane “kontratë për blerjen e automjetit të përdorur”, datë 10.01.2000, është shitur nga një shtetas me emrin Shpëtim Reka, me banim në Dusseldorf, te shtetasja L. R., me banim në Durrës, për çmimin 2.000 DM (marka gjermane). (vi) Bazuar në deklaratën doganore të zhdoganimit import 4 (e cila ka të mbivendosur datën 16.02.2000), është kryer zhdoganimi i këtij mjeti me eksportues z. Shpëtim Reka, me adresë në rrugën nr. {***}, Dusseldorf, Gjermani dhe marrëse znj. F. R. Sipas përmbajtjes së kësaj deklarate, mjeti është shitur në vlerën 2000 marka gjermane dhe është paguar taksa doganore në vlerën 88.787 lekë. (vii) Me kontratë shitje nr. {***}, datë 10.02.2000, F. R. e shet këtë automjet te subjekti i rivlerësimit, për çmimin 700.000 lekë. (viii) Me kontratë shitje nr. {***}, datë 05.06.2003, subjekti i rivlerësimit e shet këtë automjet në favor të blerësit I. H., për çmimin 200.000 lekë, shumë të cilën blerësi deklaron se e ka likuiduar.

25.4. Lidhur me çmimin e blerjes së automjetit me targë: {***}, në përgjigje të pyetësorit datë 11.11.2021, subjekti ka deklaruar se *nuk e dispononte dokumentacionin e blerjes dhe të shitjes së automjetit “Wolkswagen Golf”, me targë: {***} dhe, për shkak të kohës së gjatë nga blerja dhe shitja, nuk kujtonte të dhëna specifike në lidhje me këtë automjet.* Ndërsa lidhur me arsyen se përse bashkëshortja e tij ia ka shitur të njëjtin automjet sërish subjektit me një çmim më të lartë se çmimi i blerjes, subjekti ka deklaruar se *kjo ka ndodhur për shkak të mosmarrëveshjeve familjare që kanë pasur në atë kohë në lidhje me blerjen e automjetit.*

25.5. Në analizë të sa më sipër, pas shqyrtimit të dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja³¹ në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti, si dhe dokumentacioni³² i depozituar prej tij bashkëlidhur me përgjigjet e pyetësorit, datë 11.11.2021, megjithëse në përgjigjet që institucionet shtetërore i kanë kthyer subjektit, automjeti nuk rezulton të jetë në listën e subjekteve debitor apo me shkelje doganore³³ dhe nuk rezulton të jetë shpallur në kërkim kombëtar apo ndërkombëtar³⁴, për trupin gjykues mbetet e pakuptueshme shitja dhe më pas blerja e këtij automjeti nga subjekti te bashkëshortja e tij, në harkun kohor të një muaji.

25.6. Në përfundim të analizimit të këtij shkak ankimi, mbi problematikat e konstatuara lidhur me dokumentacionin e automjetit me targë: {***}, të cilat janë pranuar nga vetë subjekti edhe në ankimin e paraqitur në Kolegj, trupi gjykues vlerëson se veprimet e subjektit nuk janë në përputhje me etikën dhe sjelljen e duhur të gjyqtarit, dhe çmon ta konsiderojë peshën e kësaj situate të subjektit të rivlerësimit si pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

25.7. Në përfundim të verifikimit dhe kontrollit të kriterit të pasurisë, Kolegji, ashtu si edhe Komisioni, vlerëson se subjekti u gjend me probleme në këtë drejtim dhe çmon se këto defekte nuk janë të

³¹ Shkresë nr. {***} prot., datë 14.10.2021, drejtuar DPSHTRR-së; Shkresë “Kthim përgjigje” nga DPSHTRR-ja nr. {***} prot., datë 25.10.2021.

³² Deklaratë noteriale nr. {***}, datë 16.11.2021, përmes së cilës shtetasi V. Xh. deklaron se është autorizuar nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e automjetit. Fotokopje të faqes së pasaportës së shtetasit V. Xh., për të vërtetuar hyrjen dhe daljen e tij nga Gjermania në periudhën e blerjes së mjetit.

³³ Shkresë nr. {***} prot., datë 16.11.2021, e Degës së Doganës Durrës.

³⁴ Shkresë nr. {***}, datë 16.11.2021, e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës.

mjaftueshme për të arritur në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas përcaktimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Problematikat të cilat lidhen me pasuritë e vëna prej subjektit të rivlerësimit dhe me pasuritë e personave të lidhur me të, nuk konsiderohen se mund të mjaftojnë si shkaqe objektive e proporcionale të vendosura në këtë proces për të ngarkuar drejtpërdrejt me vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit, në raport me kontrollin e këtij kriteri.

25.8. Në këto kushte, Kolegji çmon se këto çështje, ndonëse nuk mjaftojnë për të arritur në konkluzionin e mësipërm si një shkak më vete shkarkimi, mjaftojnë për të arritur në konkluzionin se subjekti nuk arriti një nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë dhe, sipas nenit 59, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ato do të vlerësohen prej Kolegjit në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit, që është kryer ndaj subjektit.

Ç. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të figurës

26. Komisioni ka arritur në përfundimin se: (i) Subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, në përgjigje të pyetjes të germave “c” dhe “e”, të pjesës nr. 5, të Shtojcës 3, “Të dhëna për sigurinë”, të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka deklaruar faktin se në vitin 2012 ka marrë në huapërdorje automjetin e një personi të përfshirë në krimin e organizuar, rrethanë e cila klasifikohet sipas nenit 38/4 të ligjit nr. 84/2016. (ii) subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 4, të nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ka bërë deklarime të pasakta, duke fshehur fakte të ndodhura deri ditën e deklaramit, sipas nenit 39/2 të ligjit nr. 84/2016.

26.1. Komisioni konkludoi në vendim se subjekti i rivlerësimit, z. Shpëtim Reka, nuk ka plotësuar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, duke mos deklaruar fakte dhe rrethana të ndodhura para dorëzimit të këtij formulari. Në këto kushte, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës dhe, sipas nenit 59, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, duke e vlerësuar në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit, që është kryer ndaj tij.

26.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në lidhje me këto konstatime është vënë në dijeni nëpërmjet komunikimit gjatë procesit të rivlerësimit të tij në Komision, për këtë arsye nuk ka deklaruar si kontakt të papërshtatshëm faktin e mësipërm në deklaratën për kontrollin e figurës, pasi nëse do të kishte pasur dijeni, sigurisht që do ta kishte deklaruar, sepse nuk kishte asnjë shkak apo arsye për të fshehur marrjen me qira të një automjeti, pavarësisht identitetit të pronarit të tij. Subjekti i rivlerësimit kërkon nga Kolegji ta konsiderojë të padrejtë e të pabazuar në ligj qëndrimin e mësipërm të Komisionit, duke paraqitur argumentet si vijon:

26.2/a. Kontakti i vetëm me shtetasin Xh. T. ka ndodhur në kushte krejt rastësore dhe normale, në zyrën noteriale kur është nënshkruar marrja e automjetit në përdorim, me qëllim udhëtimin disaditor me familjen dhe dy nipat e bashkëshortes. Nuk ka asnjë njohje apo marrëdhënie fafëfisnore me këtë shtetas, nuk ka gjykuar çështje me palë shtetasin Xh. T., gjithashtu as bashkëshortja e tij, F. R., gjatë punës si prokurore, nuk ka trajtuar materiale apo procedime penale në lidhje me këtë person.

26.2/b. Automjeti me targë: {***}, është marrë me qira nga prindërit e fëmijëve që do të shoqëronte ai në udhëtim, pagesa është bërë prej tyre për të gjitha ditët e përdorimit. Për gjetjen e automjetit është interesuar shtetasi N. K. (babai i fëmijëve që do të udhëtonte me ta), i cili ka biseduar me pronarin e mjetit, si për arsyen, kohën e përdorimit, ashtu edhe pagesën për qiranë e tij. Pas përdorimit të mjetit

dhe menjëherë pas kthimit nga udhëtimi, shtetasi N. K. ka dorëzuar mjetin te pronari, në gjendje të rregullt, pa praninë e subjektit.

26.2/c. Subjekti i rivlerësimit, duke e konsideruar të gabuar, të pavërtetë dhe tendencioz konkluzionin e Komisionit, se nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se shtetasi N. K. nuk ka qenë në Shqipëri në datën që është nënshkruar kontrata e huapërdorjes, duke mbetur i pambështetur edhe pretendimi i subjektit se me marrjen me qira të automjetit është marrë ky shtetas, kërkon nga Kolegji të administrohet si provë kopja e noterizuar e pasaportës së shtetasit N. K., si dhe të administrohen të dhënat e sistemit TIMS nga Kolegji, pasi sipas të dhënave që subjekti disponon, ky shtetas ka hyrë në territorin e shtetit shqiptar në datën 09.06.2011 dhe nuk ka dalje pas kësaj date deri në datën 21 korrik 2012.

26.2/ç. Kolegji të marrë në konsideratë raportin e DSIK-së, i cili e konsideron të përshtatshëm për vijimin e detyrës, si dhe konkludimin e Komisionit për mospasjen e një marrëdhënie të vazhdueshme me këtë person, situatë kjo që e vendos atë plotësisht në kushtet e parashikuara nga neni 38, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016, për t’u konsideruar se ka disa rrethana lehtësuese, të cilat duhet të merren parasysh në vlerësimin e tij me objektivitete dhe proporcionalitet për motivet dhe argumentet ligjore, për sa i përket mosdeklarimit të shtetasit Xh. T., si kontakt i papërshtatshëm në formularin e kontrollit të figurës.

26.3. Nga shqyrtimi i akteve të administruara nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, trupit gjykues i rezulton situata faktike si vijon:

26.3/a. Gjatë verifikimit të sistemit TIMS të subjektit të rivlerësimit, Komisioni ka konstatuar, ndër të tjera, se subjekti ka udhëtuar me automjetin me targë: {***}, me dalje nga territori shqiptar nëpërmjet pikës kufitare të Qafë - Botës në datën 21.07.2012 dhe hyrje në datën 30.07.2012, nëpërmjet pikës kufitare të Kakavijës.

ii. Nga verifikimi në sistemin AMF të targës: {***} ka rezultuar se automjeti tip “Mercedes - Benz”, vit prodhimi 2009, ka qenë në pronësi të shtetasit Xh. T.

iii. Komisioni ka verifikuar në rrjetin internet me mjetin e kërkimit “Google” dhe ka konstatuar se nga informacionet e publikuara në media, ky shtetas rezulton që në vitin 2006 të jetë arrestuar dhe dënuar për trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike.

iv. Komisioni, në kuadrin e dyshimeve mbi mundësinë e kontaktit të papërshtatshëm të subjektit të rivlerësimit, ka pyetur subjektin lidhur me marrëdhënien e tij me pronarin e automjetit, me targë: {***}.

26.3/b. Në përgjigje të pyetësorit të datës 22.11.2021, subjekti ka deklaruar se: *“Udhëtimi i datës 21.07.2012 është kryer me dy automjete, atë me targë: {***} dhe automjetin tjetër, të cilin me sa kujtoj e kemi marrë më qira. Automjetin e marrë me qira e kam përdorur unë. Nuk kam dijeni se cili ka qenë apo është pronari i automjetit. Për të siguruar automjetin me qira, janë interesuar prindërit e fëmijëve që ne do të merrnim në udhëtim, T. K. dhe C. M., dhe pagesa gjithashtu është bërë prej tyre për të gjitha ditët e përdorimit...”*. Subjekti ka depozituar dokumentacion³⁵ në mbështetje të shpjegimeve të tij.

³⁵ Deklaratë noteriale nr.{***}, datë 20.07.2012, e shtetasve M. e N. K., prindër të T. K., përmes së cilës deklarojnë dakordësinë që djali i tyre të udhëtojë jashtë vendit i shoqëruar nga subjekti dhe bashkëshortja e tij. Mesazh elektronik nga shtetasi N. K., në të cilin citohet se automjeti i marrë me qira për këtë udhëtim, si dhe pagesa përkatëse është kryer nga ana e tij. Më pas është hartuar prokura dhe siguracioni ndërkombëtar për përdorimin e automjetit nga subjekti i rivlerësimit. Deklaratë e datës 17.03.2022, e shtetasit N. K., i cili konfirmon thëniet e subjektit të rivlerësimit.

26.3/c. Në përgjigje të pyetësorit të datës 22.12.2021, subjekti ka deklaruar se: *“Me shtetasin Xh. T. nuk kam asnjë njohje apo marrëdhënie farefisnie. Gjatë karrierës time si gjyqtar nuk kam rastisur të gjykoj çështje me palë shtetas me emër Xh. T., fakt të cilin e provoj me përgjigjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës³⁶. Gjithashtu, as bashkëshortja ime nuk ka trajtuar materiale apo procedime penale në lidhje me ndonjë person me emër Xh. T.”.*

26.4. DSIK-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës, pasi ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

26.5. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit³⁷ ka informuar Komisionin se me automjetin me targë: {***} ka dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë, shtetasi Shpëtim A. Reka, si drejtues i automjetit, në datën 21.07.2012, ora 15:00, nga pika kufitare e Qafë - Botës.

26.6. Ministria e Drejtësisë³⁸ ka informuar Komisionin se pranë këtij institucioni është regjistruar shkresa e Ministrisë së Drejtësisë së Italisë nr. {***} prot., datë 05.12.2005, me objekt: *“Ushtrimin e ndjekjes penale ndaj shtetasit Xh. T.”, e përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë me lëndë: “Kërkesë për ndihmë juridike e autoriteteve italiane të drejtësisë”.* Referuar akteve që i bashkëlidhen përgjigjes së Ministrisë së Drejtësisë, rezulton se shtetasi Xh. T. është shpallur fajtor për transportin në Itali të lëndëve narkotike dhe, për këtë shkak, Gjykata e Barit Itali, në datën 06.05.2005, ka vendosur masën e sigurisë arrest me burg ndaj këtij shtetasi. Kjo masë nuk është ekzekutuar për shkak të fshehjes së Xh. T. Aktet e procedimit penal i kanë kaluar Prokurorisë së Përgjithshme të Shqipërisë me qëllim fillimin e procedimit penal ndaj këtij shtetasi, për veprën penale të trafikimit të narkotikëve, parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal.

26.7. Referuar dokumentacionit të administruar, si dhe parashikimit ligjor mbi kriteret që përcaktojnë rastet se kur konsiderohet një person i përfshirë në krimin e organizuar, trupi gjykues konstaton se, në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016, shtetasi Xh. T. rezulton si “person i përfshirë në krimin e organizuar”, e për rrjedhojë, konsiderohet dhe “kontakt i papërshtatshëm” i subjektit të rivlerësimit.

26.8. Në kuadër të analizimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues mori në shqyrtim kontratën e huapërdorjes, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit për automjetin me targë: {***}, nr. {***}, datë 19.07.2012, të lidhur me pronarin e automjetit, Xh. T., të nënshkruar nga të dyja palët, në prani të noteres M. N. Referuar përmbajtjes së kësaj kontrate, rezulton se shtetasi Xh. T. e ka dhënë automjetin në përdorim të subjektit të rivlerësimit për një periudhë kohe pa afat, pa kundërshtpërblim dhe me të drejtë përdorimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

26.9. Përcaktimet e mësipërme në këtë kontratë tregojnë për një marrëdhënie të posaçme mes subjektit të rivlerësimit dhe pronarit të automjetit, Xh. T., pasi ky automjet nuk rezulton të jetë dhënë me qëllim qiradhënieje, sikurse ka pretenduar subjekti në shpjegimet e dhëna në përgjigje të pyetësorëve, por

³⁶ Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti ka depozituar shkresën nr. {***} prot., datë 28.12.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, përmes së cilës ky institucion informon se nuk rezultojnë çështje të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, në të cilat të ketë qenë palë ndërgjyqëse shtetasi Xh. T.

³⁷ Shkresë nr. {***} prot., datë 18.11.2021, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Shkresa “Kthim përgjigje” e DPPSH-së nr. {***} prot., datë 18.11.2021.

³⁸ Shkresë nr. {***} prot., datë 18.11.2021, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë; Shkresë “Kthim përgjigje”, Ministria e Drejtësisë nr. {***} prot., datë 17.12.2021.

është “huazuar” me të drejta të papërcaktuara dhe pakundërshtëpërblim nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, tagrat e përcaktuar në kontratën e huapërdorjes krijojnë bindjen e një marrëdhënieje njohjeje dhe mirëbesimi mes pronarit të automjetit dhe huamarrësit, ky argument përforcohet akoma më shumë në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur një akt, përmes së cilit të jetë revokuar apo përfunduar marrëdhënia e huapërdorjes së këtij automjeti.

26.10. Lidhur me pretendimin e subjektit, se është i pavërtetë konkluzioni i Komisionit, *se shtetasi N. K. nuk ka qenë në Shqipëri në datën që është nënshkruar kontrata e huapërdorjes, duke mbetur i pambështetur edhe pretendimi i subjektit se me marrjen me qira të automjetit është marrë ky shtetas*, trupi gjykues mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar në fashikujt e Komisionit, nga ku rezultoi se: shtetasit M. e N. K., prindër të T. K. (fëmija që ka udhëtuar me subjektin e rivlerësimit), kanë nënshkruar deklaratën noteriale nr. {***}, datë 20.07.2012, sipas së cilës deklarohen dakordësinë që djali i tyre të udhëtojë jashtë vendit i shoqëruar nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij.

26.10/a. Me qëllim analizimin e plotë të pretendimit të mësipërm të subjektit të rivlerësimit, për konstatimin e faktit nëse shtetasi N. K. ka qenë prezent në Shqipëri në periudhën e nënshkrimit të kontratës së huapërdorjes së automjetit, midis subjektit dhe shtetasit Xh. T., trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kreu verifikimet përkatëse nga të dhënat e sistemit TIMS. Nga verifikimet e kryera për vitin 2011 – 2012, rezultoi se shtetasi N. K. (identifikuar me pasaportë amerikane nr. {***}), ka hyrë në territorin shqiptar në datën 09.06.2011, ora 15:06, nëpërmjet pikës kufitare të Morinës, nuk figuron e dhënë për daljen nga territori shqiptar pas kësaj date, por rezulton hyrje e tij në datën 02.09.2012, nëpërmjet pikës kufitare Morinë. Sikurse vërehet nga të dhënat e sistemit TIMS, nuk mund të identifikohet data e daljes nga territori shqiptar i shtetasit N. K., pas hyrjes në Shqipëri më datë 09.06.2011.

26.10/b. Ndërsa nga të dhënat e verifikuara për shtetasin N. K. (me mbiemër K., por me të njëjtat gjenealitete) në sistemin TIMS (me mjet identifikimi kartë identiteti shqiptare me nr. {***}, me datë lëshimi 01.07.2010 dhe pasaportë shqiptare {***}, me datë lëshimi 13.09.2004 dhe datë skadence 12.09.2014), konstatohet se në këtë sistem gjenden të dhëna për hyrje dhe dalje nga territori shqiptar i këtij shtetasi për periudhën para vitit 2008 dhe pas vitit 2017. Këto të dhëna nuk ndihmojnë për të identifikuar periudhën e qëndrimit në Shqipëri të shtetasit N. K., në muajin korrik të vitit 2012.

26.10/c. Gjithashtu, nga Njësia e Shërbimit Ligjor në Kolegj, u verifikuan të dhënat që përmban fotokopja e noterizuar e pasaportës në emër të N. K., lëshuar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, nr. {***}, datë lëshimi 07.04.2010 dhe datë skadence 06.04.2020. Konstatohet se vulat e vendosura në pasaportë në pikat e kalimit të kufirit³⁹ i përkasin periudhave nga viti 2010 – 2017, por që nuk japin të dhëna për hyrje dalje të shtetasit N. K. gjatë periudhës korrik 2012.

26.10/ç. Trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht këtij konstatimi, në kushtet kur kontratën e huapërdorjes pa kundërshtëpërblim të përdorimit të automjetit me targë: {***}, me shtetasin Xh. T., e

³⁹ Për nevoja të hetimit gjyqësor u analizuan të dhënat që i përafrohen më shumë periudhës korrik të vitit 2012, nga ku rezulton: vulë e vendosur nga dogana e Malit të Zi, e datës 14.01.2011; vulë hyrëse në aeroportin e Vjenës, datë 23.05.2011; vulë hyrëse në portin e Durrësit, datë 28.05.2001; vulë e vendosur nga dogana e Kosovës për hyrje me automjet, datë 09.06.2011; vulë hyrëse në aeroportin e Vjenës, datë 01.10.2012; vulë dalje nga aeroporti Vjenës, datë 04.10.2012; vulë hyrëse në aeroportin e Rinasit, datë 04.10.2012. Gjithashtu rezulton të jenë vendosur disa vula nga autoritetet doganore, tek të cilat janë të pamundura për t'u identifikuar datat apo pika kufitare e kalimit.

ka nënshkruar subjekti i rivlerësimit, mbetet në nivel deklarativ pretendimi i subjektit, se për gjetjen e automjetit është interesuar shtetasi N. K.

26.11. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se nuk ka qenë në dijeni të dënimit të shtetasit Xh. T., trupi gjykues, sipas një interpretimi sistematik dhe logjik të dispozitave ligjore, vlerëson se detyrimi për deklarim duhet të shtrihet vetëm ndaj kontakteve me persona, anëtarësia e dyshuar e të cilëve në krimin e organizuar ishte e njohur, publikuar dhe e regjistruar në momentin e takimit/kontaktit me subjektin e rivlerësimit. Në kushtet kur faktet mbi dënimin e shtetasit Xh. T. dhe aktivitete të dyshuara rezultojnë të regjistruara në regjistrat përkatës në Shqipëri që në vitin 2006, subjekti i rivlerësimit, aq më tepër në funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duhet ta kishte vlerësuar këtë situatë si rrethanë që duhej të deklarohet në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, në muajin janar të vitit 2017.

26.12. Nga sa më lart, trupi gjykues vlerëson se kriteri kohor i përcaktuar në mënyrë të shprehur në pikën 2, të nenit Dh, të Aneksit të Kushtetutës, i referohet detyrimit për plotësimin e deklaratës së detajuar për figurën dhe deklarimit në këtë kuadër, me saktësi dhe në përputhje me rubrikat përkatëse të saj, të çdo informacioni, të dhënë apo rrethane të ndodhur apo kërkuar brenda këtij afati kohor. Vetë përcaktimi i këtij afati, me pikënisje datën 1 janar 2012 dhe pikë fundore datën e deklarimit sipas ligjit, konfirmon më së miri se, në lidhje me këtë periudhë kohore, do të vlerësohet saktësia dhe vërtetësia e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, një ndër elementet e përcaktuara në objektin e kontrollit të figurës, sipas nenit 34 të ligjit nr. 84/2016.

26.13. Në analizë të situatës faktike si më sipër, në raport me rregullimet ligjore të parashikuara referuar pikës 2, të nenit Dh, të Aneksit të Kushtetutës, kjo deklaratë ka vlerën e provës në këtë proces dhe se deklarimi i pasaktë sjell pasoja për subjektet e rivlerësimit, legjislatori ka përcaktuar për këtë qëllim një afat të arsyeshëm e të përshtatshëm kohor për subjektet e rivlerësimit për të përmbushur këtë detyrim. Gjithashtu, në referim të nenit 38, pika 6, shkronja “a”, në të cilin citohet se: *“Rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklarimit nuk është i plotë dhe i besueshëm, janë kur: a) subjekti i rivlerësimit nuk rendit në listë një kontakt që është konstatuar nga prova të besueshme”*. Trupi gjykues, sa i përket mosdeklarimit nga subjekti i rivlerësimit të faktit se ai ka pasur kontakt me një person të përfshirë në krimin e organizuar, pra z. Xh. T., me të cilin ka nënshkruar një kontratë huapërdorje automjeti dhe ka udhëtuar me këtë automjet, në korrik të vitit 2012, vlerëson se kjo situatë faktike dhe ligjore lidhet me deklarimin e pamjaftueshëm të kriterit të kontrollit të figurës.

26.14. Në përfundim të analizimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konstatimin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, në përgjigje të pyetjes të germave “c” dhe “e”, të pjesës nr. 5, të “Shtojcës 3”, *“Të dhëna për sigurinë”*, ka bërë deklarime të pasakta, duke fshehur fakte të ndodhura deri ditën e deklarimit, sipas nenit 39/2 të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës.

Trupi gjykues, referuar nenit 59, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, do ta vlerësojë këtë situatë të subjektit në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit, që është kryer ndaj tij.

27. Konflikti i interesit

27.1. Në lidhje me gjendjen e “konfliktit të interesit” të subjektit të rivlerësimit në gjykimet e çështjeve me palë ndërgjyqëse shoqërinë “{***}” ShPK apo z. R. K., administrator i kësaj shoqërie, Komisioni

ka konstatuar se, për shkak të parashikimeve ligjore, neni 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, subjekti ishte i detyruar të hiqte dorë nga gjykimi i çështjeve në fjalë, me qëllim shmangien e një situatë të konfliktit të interesit, duke qenë se mes tij dhe shtetasit R. K. ekzistonte një marrëdhënie njohjeje, e cila mund të konsiderohej se do të ndikonte në vendimmarrjet e subjektit. Për më tepër, subjekti në dy raste ka udhëtuar me z. K., ndërkohë që kishte në gjykim çështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë e këtij shtetasi.

27.2. Në vlerësim të rrethanave të sipërcituara, Komisioni ka vlerësuar se këto rrethana janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit, e cila duhet të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

27.3. Subjekti, në ankimin e paraqitur në Kolegj, pretendon se vendimmarrja e tij në çështjet gjyqësore me shoqërinë “{***}” ShPK ka qenë e drejtë dhe e pandikuar nga rrethana jashtëgjyqësore, në njërin rast ka dhënë vendim pushimi, i cili nuk konsiderohet si gjykim në favor të asnjërës palë, pasi mosparaqitja e palës në gjykim passjell pushimin e gjykimit. Në çështjen tjetër, subjekti pretendon se ka qenë vetëm njëri prej tre anëtarëve të barabartë të trupit gjykues dhe, pasi vendimi është prishur nga Gjykata e Apelit për shkaqe procedurale, edhe në rigjykim,⁴⁰ vendimmarrja e Gjykatës së Shkallës së Parë ka qenë e njëjtë më atë të vendosur prej tij me vendimin e datës 10.03.2017. Sipas subjektit, marrëdhënia me shtetasin R. K., asnjëherë nuk ka qenë marrëdhënie shoqërore, por vetëm njohje si bashkëqytetar.

27.4. Në kuadër të analizimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues mori në shqyrtim dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ në Komision, e analizoi atë në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe aktet e sjella prej tij, dhe konstaton si vijon.

27.5. Gjatë hetimit administrativ në Komision ka rezultuar se, nga verifikimet e kryera nga të dhënat e sistemit TIMS, në datat 21.11.2011 dhe 27.09.2015, subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar së bashku me shtetasin R. K., administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, me automjetet me targë: {***} dhe {***}, të regjistruara në pronësi të z. {***}.

Sipas informacionit të administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar 7 (shtatë) çështje gjyqësore me shtetasin R. K. Nga shqyrtimi i dokumentacionit që lidhet me këto gjykime, ka rezultuar se në datat e udhëtimeve të kryera nga subjekti me shtetasin R. K., ai ka pasur në shqyrtim e sipër çështjet gjyqësore të mëposhtme:

(i) Çështje gjyqësore me paditës shoqërinë “{***}” ShPK, të paditur “{***}” ShA, me objekt *“Detyrimi i të paditurit t’i paguaj paditësit shumën prej 60,000 dollarë amerikanë dhe marrjen e masës për sigurimin e padisë, duke bllokuar anijen e të paditurit”*, regjistruar më datë 23.03.2011. Me vendimin datë 01.12.2011, subjekti i rivlerësimit ka vendosur “pushimin e gjykimit” për shkak se paditësi nuk është paraqitur në seancë gjyqësore.

(ii) Çështje gjyqësore me paditës A., L. e Y. K. dhe të paditur shoqërinë “{***}” ShPK, me objekt *“Detyrimin e të paditurit të dorëzojë pasuritë e përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes, të kryejë regjistrimin e tyre në regjistrat hipotekorë në emër të paditësve etj.”*, regjistruar më datë 05.11.2014. Në këtë gjykim, subjekti ka pasur cilësinë e kryesuesit të trupit gjykues, i cili, me vendimin datë

⁴⁰ Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur së bashku me ankimin, vendimin nr. {***}, datë 04.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, gjykuar nga një tjetër trup gjykues pas rikthimit nga Gjykata e Apelit, e cila ka vendosur përsëri *“Rrëzimin e kërkesëpadisë së paditësve A. K., L. K. dhe Y. K., si e pambështetur në prova dhe në ligj.”*

10.03.2017, ka vendosur “rrezimin e kërkesëpadisë”, si të pambështetur në prova dhe në ligj. Ky vendim rezulton të jetë prishur nga Gjykata e Apelit Durrës.

27.6. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka shpjeguar se, nga të dhënat e sistemit informatik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, rezulton se subjekti “{***}” ShPK ose R. K. ka zhvilluar gjithsej 137 gjykime në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, prej të cilave ai, si pjesë e trupës gjyqësore, ka gjykuar vetëm 7 prej tyre. Ndërsa lidhur me praninë e tij në automjetin e shtetasit R. K., më datë 27.09.2015, për udhëtimin nga Prizreni në Kukës, subjekti pretendon se ishte krejt rastësor⁴¹ dhe nuk e vendos atë në kushtet e nenit 72, pika 6, pasi një kontakt i tillë nuk mund të barazohet me rastet e cilësuar në pikat e tjera të kësaj dispozite, për më tepër, në vlerësimin e tij, ai ishte tërësisht i preokupuar vetëm për shëndetin e bashkëshortes. Subjekti i rivlerësimit thekson se duhet konsideruar në këtë rast, fakti që palë në gjykim ka qenë kompania “{***}” ShPK, e përfaqësuar nga avokatët e saj dhe jo nga ortakët e vetëm, dhe ky element ndoshta nuk e ka ndihmuar të kujtojë në memorien e tij këtë udhëtim dhe ta identifikojë atë si element që mund të çojë në aplikimin e nenit 72 të K. Pr. Civile. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka depozituar në Komision dokumentacion shkresor⁴².

27.7. Lidhur me çështjen gjyqësore me paditës shoqërinë “{***}” ShPK, të paditur “{***}” ShA, me objekt: *“Detyrimi i të paditurit t’i paguajë paditësit shumën prej 60.000 dollarë amerikanë dhe marrjen e masës për sigurimin e padisë, duke bllokuar anijen e të paditurit”*, regjistruar më datë 23.03.2011, trupi gjykues konstaton se, vërtet me vendimin datë 01.12.2011, subjekti i rivlerësimit ka vendosur “pushimin e gjykimit”, për shkak se paditësi nuk është paraqitur në seancë gjyqësore, por më parë subjekti, me vendimin nr. {***}, datë 08.03.2011, ka dhënë vendimin në favor të shoqërisë “{***}” ShPK, duke vendosur pranimin e kërkesës së palës kërkuese, shoqërisë tregtare “{***}” ShPK, për marrjen e masës së sigurimit të padisë para ngritjes së padisë. Sipas dispozitivit të këtij vendimi rezulton se subjekti i rivlerësimit ka vendosur sekuestrimin e mjetit lundrues “{***}” me flamur shqiptar, është urdhëruar Kapitenaria e Portit Durrës të kryejë bllokimin e anijes “{***}” dhe të mos lejojë largimin e saj nga portet shqiptare, deri në përfundimin e gjykimit të çështjes me vendim të formës së prerë.

27.8. Trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se udhëtimi me shtetasin R. K. ishte rastësor, pasi nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se subjekti ka udhëtuar me automjetin e shtetasit R. K., jo vetëm më datë 27.09.2015, por edhe më datë 21.11.2011, çka krijon bindjen për një njohje më të thellë të subjektit të rivlerësimit me këtë shtetas.

27.9. Nga rastet e analizuara më lart, trupi gjykues konstaton se subjekti nuk ka vepruar për të shmangur situata të konfliktit faktik të interesit apo atij në dukje, porë kjo edhe me rëndësinë që ka besimi dhe perceptimi i publikut në pavarësinë, etikën, integritetin dhe paanshmërinë që magjistrati duhet të kujdeset të reflektojë. Ky detyrim, përveç se gjen rregullim specifik në dispozitat përkatëse

⁴¹ Unë kisha shkuar në Prizren së bashku me shtetasin A. L., të cilin e kam shok prej vitesh. Kur kam qenë atje, fëmijët më kanë njoftuar në telefon se bashkëshortja ishte e sëmurë (me probleme {***}) dhe, për këtë shkak, jam detyruar të kthehem menjëherë. Jam kthyer deri në një pjesë të rrugës me shtetasin R. K., të cilin e pamë rastësisht në pikën e kalimit të kufirit në Prizren. Rrugës, pranë Kukësit, më ka dalë përpara i fejuari i vajzës me automjetin e tij dhe jemi kthyer menjëherë në Durrës. Bashkëshortja, në vitin 2015, ka pasur në disa raste probleme shëndetësore dhe për këtë ju paraqes si provë disa nga dokumentet shëndetësore, që disponoj për periudhën qershor - dhjetor 2015, të bashkëshortes F. R. Kjo situatë nuk mund të përbëjë një të dhënë, e cila do të më vendoste në kushtet e nenit 72 të K. Pr. Civile. Dispozita në fjalë i ka të qartësuar se cilat janë marrëdhëniet që mund të çojnë gjyqtarin në dorëheqje, tipologjia e të cilave konstatohet se janë marrëdhënie të tilla të lidhjeve familjare, të miqësisë apo armiqësisë që ndikojnë vendimarrjen.

⁴² Të dhëna nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore; Dokumente shëndetësore për F. R.; Deklaratë noteriale nga A. L., nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.02.2022; Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nr. {***}, datë 04.10.2021 (nga sistemi).

të kreut V të Kodit të Procedurës Civile dhe në ligjin nr. 9367/2005,⁴³ “Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, ka gjetur vend edhe në ligjin e posaçëm nr. 96/2016, për statusin e magjistratëve, nenet 3⁴⁴, 4⁴⁵ dhe në vijim të tij.

Për sa më sipër, referuar edhe në kriteret e vlerësimit sipas nenit 75, pika 4⁴⁶ e ligjit nr. 96/2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk është kujdesur për shmangien e konfliktit të interesit faktik dhe atij në dukje. Raste në të cilat, në pamje të parë, më së paku do të paragjykonin paanshmërinë e vendimmarrjes, pasi në to ndërthuret gjykimi i subjektit gjatë procedurave gjyqësore, me udhëtimet e kryera me administratorin e shoqërisë “{***}” ShPK, z. R. K. Një situatë e tillë eventualisht mund të minojë besimin që gjykatat duhet të frymëzojnë te shoqëria dhe publiku.

27.10. Në përfundim, në lidhje me gjendjen në kushtet e “konfliktit të interesit” të subjektit të rivlerësimit në gjykimet e çështjeve me palë ndërgjyqëse shoqërinë “{***}” ShPK, ku ortak i vetëm ishte R. K., Kolegji vlerëson se, bazuar në nenin 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, subjekti i rivlerësimit duhet të hiqte dorë nga gjykimi i çështjeve në fjalë, me qëllim shmangien e një situatë të konfliktit të interesit, në kushtet kur mes tij dhe shtetasit R. K. ekzistonte një marrëdhënie e tillë miqësore, ku të paktën në dy raste ka udhëtuar edhe jashtë shtetit, situatë kjo që konsiderohet se do të ndikonte në vendimmarrjet e subjektit. Në vlerësim të fakteve dhe të rrethanave të rezultuara gjatë hetimit në raport edhe me shpjegimet e subjektit, trupi gjykues çmon se tërësia e veprimeve të subjektit të rivlerësimit tregojnë një raport të tillë të mungesës së përkujdesjes për zbatimin e ligjit, i cili është i papranueshëm për të pasur besimin e publikut. Trupi gjykues vlerëson se këto rrethana janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

28. Trupi gjykues çmon se, në çdo situatë faktike e ligjore, organet e rivlerësimit kanë të drejtë të bëjnë një vlerësim tërësor të të tria kriterëve ose të procedurave të rivlerësimit, për të matur apo indikuar cenimin e besimit të publikut te drejtësia dhe për të konkluduar nëse ky fenomen ka ndodhur në rastin konkret dhe a është ai në një nivel që të prodhojë vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke e parashikuar cenimin e besimit të publikut në nivelin e shkeljes disiplinore, e cila passjell shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, kërkon që cenimi i besimit të publikut të jetë i konsiderueshëm apo i perceptueshëm si i tillë, për shkaqe e shkelje konkrete, të cilat duhet të arsyetohen qartësisht e plotësisht.

29. Kolegji arrin në konkluzionin se subjekti dhe personat e lidhur me të, jo vetëm kanë disponuar e gëzuar pasuri, të cilat rezultojnë me problematika në drejtim të legjitimitetit të burimeve të tyre, por edhe ka rezultuar se subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe nuk ka plotësuar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, duke mos deklaruar faktin që i ka marrë në huapërdorje automjetin shtetasit Xh. T.

⁴³ Në ligjin nr. 9367/2005, “Mbi parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, në nenin 3, pika 4/b, përkufizohet: b) “Konflikt në dukje i interesit” është gjendja, në të cilën interesat privatë të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësi të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë”.

⁴⁴ “Magjistrati ushtron funksionet gjyqësore në mënyrë të paanshme, pa ndikim dhe pa paragjytime. 5. Sjellja e magjistratit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij garanton ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, profesioni ligjor dhe palëve në proces.”

⁴⁵ “Magjistrati merr të gjitha masat për të mbrojtur dhe forcuar: a) dinjitetin dhe standardet e funksionit të tij; b) reputacionin e organeve të drejtësisë dhe besimin e publikut në sistemin gjyqësor dhe atë të prokurorisë; c) statusin e funksionit të magjistratit.”

⁴⁶ “Paanësia e magjistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit [...]”.

30. Në përfundim, në analizë të përgjithshme të konkluzioneve të arritura për të tria kriteret dhe në vlerësimin tërësor të procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, gjatë ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, duke u plotësuar kushtet dhe rrethanat për zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, vendimi nr. 512, datë 25.02.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 512, datë 25.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Shpëtim Reka.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 23.01.2025.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol Çomo

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e relatores së çështjes, jam shprehur dakord me vendimin nr. 5, datë 23.01.2025, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim Kolegji), që i përket subjektit të rivlerësimit Shpëtim Reka, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 512, datë 25.02.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), por kam mendim paralel me shumicën e trupit gjykues, për sa i përket qëndrimit të mbajtur dhe konkluzionit të arritur, lidhur me kualifikimin ligjor që i është dhënë shkarkimit të subjektit.
2. Trupi gjykues i Kolegjit, në paragrafin 30 të vendimit, është shprehur: *“Në përfundim, në analizë të përgjithshme të konkluzioneve të arritura për të tria kriteret dhe në vlerësimin tërësor të procedurave, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, gjatë ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar, ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke u plotësuar kushtet dhe rrethanat për zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për pasojë, vendimi nr. 512, datë 25.02.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e tij nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi”*.
3. Komisioni në vendim, në konkluzionin përfundimtar, ndër të tjera, është shprehur se: *“...në një analizë të përgjithshme të të gjitha konkluzioneve të arritura e të arsyetuara në vendim, subjekti dhe personat e lidhur me të, jo vetëm kanë disponuar e gëzuar pasuri, të cilat rezultojnë me problematika në drejtim të legjitimitetit të burimeve të tyre, por edhe ka rezultuar se subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe nuk ka plotësuar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, duke mos deklaruar faktin që i ka marrë në huapërdorje automjetin shtetasit Xh. T. Në këtë këndvështrim, Komisioni, nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, vlerëson se përgjatë ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar, subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke u plotësuar kushtet dhe rrethanat për zbatimin e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016...”*.
4. Në një vlerësim të përgjithshëm për procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit Shpëtim Reka, kam shprehur mendim ndryshe me shumicën e trupit gjykues, duke i dhënë pasojë për shkarkimin nga detyra subjektit, duke e kualifikuar sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2026, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), pasi subjekti ka bërë deklaramit të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, duke mos plotësuar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës. Në vlerësimin tim, subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, dhe nuk gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
5. *Për kriterin e vlerësimit të pasurisë*, duke qenë dakord me situatën faktike të trajtuar në këtë vendim të Kolegjit, në lidhje me konkluzionin përfundimtar për pasurinë, kam vlerësuar se, edhe pse u konstatuan disa problematika në këtë kriter, ato nuk arritën në nivelin që subjekti i rivlerësimit të gjendej në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, e për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë, duke argumentuar sa më poshtë.

5.1 Për pasurinë “apartament me sipërfaqe 70.7 m²”, ndodhur në rrugën “{*}”, pranë stadiumit “{***}”, Tiranë,** vlerësoj se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë në deklaratën vetting këtë pasuri, duke përshkruar mënyrën e përfitimit pjesërisht nga dhurimi dhe pjesërisht me kontratë shitjeje, ku krahas çmimit të shitjes është paguar edhe vlера shtesë. Komisioni i ka dhënë pasojë subjektit për këtë pasuri, duke e penalizuar për mospasqyrimin saktësisht të mënyrës së përfitimit të kësaj pasurie dhe çmimit të blerjes së saj, duke e konsideruar si defekt me peshë në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë për të gjitha elementet e tij. Po ashtu, i njëjti qëndrim është mbajtur edhe nga shumica e trupit gjykues në paragrafët 20.4 - 20.5 të vendimit të Kolegjit.

5.1.1 Në ndryshim nga pjesa tjetër e trupit gjykues, ndaj mendimin se kjo është një pasuri e fituar me trashëgimi nga personi i lidhur, bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, dhe as Komisioni e as shumica e trupit gjykues,

edhe pse e kanë pranuar këtë fakt, nuk e kanë konsideruar atë. Pavarësisht disa pasaktësive që u konstatuan në dokumentacionin e krijimit të kësaj pasurie lidhur me një kontratë të mirëfilltë dhurimi në emër të bashkëshortes së subjektit nga babai i saj, rezulton e provuar qartësisht se kjo është një pasuri, që burimin kryesor e ka nga trashëgimia, edhe pse evidentohet që nuk janë ndjekur me rigorozitet etapat për kalimin e pronësisë nga babai te vëllai e më pas te bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit. Nga ana tjetër, si Komisioni, edhe shumica e trupit gjykues pranojnë faktin se origjina e kësaj prone provohet me dokumentacion shkresor referuar dispozitave të Kodit Civil.

5.1.2 Lidhur me çmimin për pjesën e blerë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, edhe pse konstatohen disa pasaktësi mospërputhjeje të kontratës së shitjes me vlerën e deklaruar në deklaratën *vetting*, nga analiza financiare e kryer si nga Komisioni edhe nga Kolegji, rezulton e provuar se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e pasurisë “apartament” dhe për rrjedhojë kjo pasuri rezulton të jetë përfituar me burime të ligjshme financiare.

5.2 Për pasurinë “apartament 3+1 me sipërfaqe 146.5 m²”, ndodhur në lagjen nr. {***}, rruga “{***}”, kati {***}, Durrës, me vlerë 70.000 euro, vlerësoj se për krijimin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të saktë në deklaratën *vetting* të kësaj pasurie dhe të burimeve të përdorura për krijimin e saj. Komisioni dhe pjesa tjetër e trupit gjykues në vendim kanë konfirmuar mungesën e burimeve të ligjshme financiare, konstatuar për kryerjen e disa pagesave në vlerën prej 963.112 lekësh. Megjithatë, prej tyre është konsideruar se subjekti në vitin 2004 ka pasur gjendje *cash* në shumën prej 1 milion lekë dhe në vitin 2005 ka pasur një rezultat pozitiv në shumën prej 2.411.229 lekësh, që rezulton për shkak të pasaktësisë në deklarimin e kursimeve *cash* në DPV-të në vite të subjektit, e për rrjedhojë, pamundësia financiare nuk mund të ngrihet në atë nivel që ta kualifikojë atë si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

5.2.1 Për sa më lart, vlerësoj se pjesa tjetër e trupit gjykues, në paragrafët 21.8 - 21.9 të vendimit, ashtu si Komisioni, kanë rënduar pozitën e subjektit të rivlerësimit, duke çmuar që ta vlerësojnë medoemos peshën e tyre në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, sipas një vlerësimi që lidhet me të gjitha rrethanat e çështjes, e për pasojë, ta penalizojnë subjektin padrejtësisht.

5.2.2 Lidhur me konstatimin e Komisionit, se pagesa e kështit të fundit, prej 7000 eurosh, për pasurisë “apartament 3+1, me sipërfaqe 146.5 m²”, ndodhur në Durrës, blerë nga shoqëria ndërtuese “{***}” ShPK, në vlerën prej 70.000 eurosh, është kryer në kushtet e konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues në vendim, duke konfirmuar konkluzionin e komisionit për ekzistencën e konfliktit të interesit, shprehet se: “22.5/dh - Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se kjo situatë e subjektit të rivlerësimit do të konsiderohet si pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016”.

5.2.3 Si relatore kam ndarë të njëjtin mendim me shumicën e trupit gjykues dhe arsyetimin e bërë në vendim, për ekzistencën e gjendjes së konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit në këtë rast, të cilin ai mund ta kishte shmangur, edhe pse rezulton të jetë një vendim i dhënë jo për zgjidhje të një konflikti në themel, por një vendim administrativ për të lejuar ekzekutimin e një vendimi gjykate që ka marrë formë të prerë dhe është kthyer në titull ekzekutiv, por nuk jam e të njëjtit mendim me pjesën tjetër të trupit gjykues, për ta konsideruar këtë situatë të subjektit të rivlerësimit me peshë ndëshkuese në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016. Në mendimin ndryshe mbaj në konsideratë rrethanën se vlera e kështit të fundit prej 7000 eurosh, konsideruar paguar në datën e nënshkrimit të kontratës së shitblerjes, më 17.11.2011, në raport me çmimin e apartamentit, prej 70.000 eurosh, është e tillë që nuk duhet të afektojë marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit. Gjithashtu, nga analiza financiare e kryer deri në datën e lidhjes së kontratës së shitblerjes, më 17.11.2011, rezulton se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi që të kryente pagesën prej 7000 euro dhe të përballonte shpenzimet.

5.3 Lidhur me pasurinë “apartament me sip. 51 m²”, ndodhur në lagjen nr. {***}, Durrës, e deklaruar nga djali, E. R., e përfituar më anë të testamentit të lënë nga nëna e bashkëshortes së tij, V. A., vlerësoj se kjo

pasuri është përfitur nga djali i subjektit të rivlerësimit, në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji⁴⁷, pas çeljes së trashëgimisë me testament, e cila nuk përfshihet në sferën e veprimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

5.3.1 Për këtë pasuri konstatoj se në vendimin e Kolegjit është konfirmuar konkluzioni i Komisionit, se pas kalimit të barrës së provës, rezultoi i provuar që burimi primar i kësaj pasurie është testamenti⁴⁸ i regjistruar nga gjyshja e djalit të subjektit të rivlerësimit, me numër {***} regj., në datën 31.07.2008 dhe subjekti nuk gjendet para dyshimit të një pasurie të fshehur.

5.3.2 Në këto kushte, vlerësoj se krijimi i kësaj pasurie nuk mund t'i nënshtrohet verifikimit në kuadër të procesit të rivlerësimit sa i përket ligjshmërisë së burimit të të ardhurave për ta konsideruar gjyshen e djalit të subjektit person tjetër të lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Këtë e shoh të lidhur edhe me faktin se në rastin e veprimit juridik të kryer nga ana e gjyshes, e cila nuk përbën as dhurim e as huadhënie, nënshtrimi ndaj kontrollit në funksion të rivlerësimit të subjektit, në kushtet kur nga Komisioni është pranuar qartësisht se nuk jemi para një pasurie të fshehur, përbën një tejkalim të fushës së veprimit të ligjit nr. 84/2016 dhe rëndim të padrejtë të situatës së subjektit për kriterin e pasurisë.

5.4 *Lidhur me të ardhurat e përfituara ndër vite, nga qiradhënia e apartamentit të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, me sip.70.7m², vlerësoj se për të ardhurat nga qiraja të përfituara për periudhën korrik 2008 – 2011, ato duhet të përfshihen në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.*

5.4.1 Për sa kohë rezulton e provuar dhe e pranuar që marrëdhënia e qirasë, sipas kontratës së vitit 1 janar 2007 – 1 janar 2008, është përsëritur në vazhdim me veprime konkludente, edhe pas mbarimit të afatit të kontratës, me të njëjtat kushte e me të njëjtat palë, dhe provohet që qiramarrësi në vitin 2008 figuron i regjistruar në organet tatimore, për rrjedhojë, detyrimi ligjor për pagimin e tatimit të qirasë i takon këtij të fundit. Gjithashtu, subjekti i ka deklaruar rregullisht të ardhurat nga qiraja në deklaratat periodike të kohës. Në kontratat e qirasë të lidhura nga bashkëshortja e subjektit me këtë shtetas përcaktohet qartësisht se apartamenti është dhënë me qira për ambiente pune, në kontratat e qirasë të vitit 2006 – 2008 është parashikuar se tatimi i fitimit për qiranë do të paguhet nga qiramarrësi, ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33, pika 1, germa “ë”, parashikon detyrimin e subjektit qiramarrës, në rastet kur ai është person juridik, për të mbajtur dhe paguar tatimin në burim⁴⁹.

5.4.2 Të ardhurat nga qiratë, për periudhën 2008 – 2011, rezultojnë përafërsisht në vlerën 1.296.000 lekë, e cila, nëse do të ishte përfshirë në analizën financiare për periudhën e mësipërme, diferencat negative të konstatuara për vitet 2008 dhe 2011 do të uleshin ndjeshëm.

5.5 *Për pasurinë “automjet me targa {***}”, që ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit “Mercedes - Benz”, vlerësoj se kjo pasuri nuk është pjesë e deklaratës vetting, dhe parregullsitë e konstatuara me dokumentacionin për fitimin e pronësisë së këtij mjeti të vitit 1999, si dhe veprimet juridike me të nuk kanë sjellë pasoja në drejtim pagimit të detyrimeve doganore apo shkaktimit të problematikave ligjore. Këto veprime, të cilat janë pranuar nga vetë subjekti i rivlerësimit, edhe pse duken të pakuptimshme e që mund të ishin shmangur, çmoj se nuk marrin ndonjë relevancë domethënëse në funksion të procesit të tij të rivlerësimit dhe, për rrjedhojë, në ndryshim nga arsyetimi në paragrafin 25.6 të vendimit të Kolegjit, nuk duhet të marrin peshë për të ndikuar në procesin e rivlerësimit të subjektit për t'u konsideruar në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016.*

⁴⁷ Kodi Civil, neni 372, “Kuptimi i testamentit”; neni 373, “Zotësia për të disponuar me testament” dhe neni 397, “Testamenti me akt noterial”.

⁴⁸ Në datën 11.05.2016, notare M. N. ka lëshuar Dëshminë e trashëgimisë testamentare dhe ligjore nr. {***}/{***}, për trashëgimlënësen V. A., duke përcaktuar si trashëgimtar të vetëm testamentar z. E. R. - nipin e saj, i cili trashëgoi apartamentin me sipërfaqe 51m².

⁴⁹ Qëndrim i mbajtur nga ana ime me mendim paralel edhe në rastin e subjektit të rivlerësimit F. P., vendimi nr. 5, datë 21.02.2023, i Kolegjit.

6. Për kriterin e vlerësimit të figurës, jam dakord me arsyetimin në vendimin e Kolegjit në paragrafët 26.8 - 26.14, të mënyrës së vlerësimit të rrethanave faktike dhe konkluzionit të arritur lidhur me marrëdhënien e subjektit të rivlerësimit me shtetasin Xh. T., si person i përfshirë në krimin e organizuar⁵⁰ dhe përdorimit të automjetit të këtij të fundit për udhëtim jashtë shtetit me familjen⁵¹, duke konkluduar për pasaktësi në formularin e deklarimit të figurës. Në përfundim, është konkluduar se: “26.14 - Në përfundim të analizimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konstatimin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, në përgjigje të pyetjes të germave “c” dhe “e”, të pjesës nr. 5, të “Shtojcës 3”, “Të dhëna për sigurinë”, ka bërë deklarime të pasakta, duke fshehur fakte të ndodhura deri ditën e deklarimit, sipas nenit 39/2 të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës. Trupi gjykues, referuar nenit 59, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, do ta vlerësojë këtë situatë të subjektit në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit, që është kryer ndaj tij”.

6.1 Në ndryshim nga pjesa tjetër e trupit gjykues, kam vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e kontrollit të figurës, sepse konstatohet që, në formularin e deklarimit të figurës, nuk ka deklaruar kontaktin me Xh. T., sipas parashikimit të nenit 38, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, e për rrjedhojë, ka bërë deklarim të pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 të këtij ligji. Edhe pse subjekti i rivlerësimit ka mohuar ekzistencën e kontaktit të drejtpërdrejtë apo të njohjes së këtij shtetasi, mendoj se me aktet e sjella në cilësinë e provës, ai nuk arriti të provojë në Komision që: (i) kontrata e huapërdorjes të automjetit me tagra të pakufizuara të mos jetë firmosur njëkohësisht mes të dy palëve, si dhe (ii) marrja dhe dorëzimi i automjetit të mos jetë bërë mes tyre personalisht, të cilat konsiderohen si komunikim jorastësor, sipas nenit 38, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

6.1.1 Gjithashtu, në rrethanat që mund të rendis, përveç atyre në vendim janë edhe: (i) fakti që mbetet e pashpjegueshme marrëdhënia e subjektit me shtetasin Xh. T. lidhur me huapërdorjen apo qiranë për një automjet të shtrenjtë, e cila mund të jepet në kushtet e një marrëdhënieje besimi reciprok dhe jo ndaj një të panjohuri apo ndërmjetësi; (ii) në deklaratën e lëshuar nga N. K., më 17.2.2022, merret përsipër prej tij gjetja e mjetit për udhëtim jashtë vendit, por në asnjë moment nuk përmendet emri i personit që i është marrë ky mjet, edhe pse fakti ka ndodhur në vitin 2011, duke e bërë të pabesueshme këtë deklaratë; (iii) në vitin 2006 ka pasur sinjalizime që këtij personi i janë sekuestruar pasuritë, një fakt i bërë publik.

6.2 Në vlerësimin tim si relatore, analiza e bërë në vendim për këtë kriter duhet të merrte një peshë të posaçme dhe subjekti i rivlerësimit duhej të merrte masën disiplinore të shkarkimit nga detyra bazuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe sipas kualifikimit ligjor në paragrafin e mësipërm, për deklarim të pamjaftueshëm lidhur me formularin e deklarimit të figurës dhe jo sipas vlerësimit të përgjithshëm të të tri kriterëve.

7. Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prania e subjektit të rivlerësimit në gjykimet e çështjeve me palë ndërgjyqëse me shoqërinë “{***}” SHPK⁵², ku për shkak të parashikimeve ligjore, neni 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, subjekti ishte i detyruar të hiqte dorë nga gjykimi i çështjeve në fjalë, me qëllim shmangien e një situatë të konfliktit të interesit, duke qenë se mes tij dhe shtetasit R. K. ekzistonte një marrëdhënie njohjeje, si dhe rezulton se ka udhëtuar me këtë të fundit, ndërkohë që kishte

⁵⁰ Referuar akteve që i bashkëlidhen përgjigjes së Ministrisë së Drejtësisë, rezulton se shtetasi Xh. T. është shpallur fajtor për transportin në Itali të lëndëve narkotike dhe, për këtë shkak, Gjykata e Barit Itali, në datën 06.05.2005, ka vendosur masën e sigurisë “arrest me burg” ndaj këtij shtetasi. Kjo masë nuk është ekzekutuar për shkak të fshehjes së Xh. T.

⁵¹ Referuar kontratës së huapërdorjes nr. {***}/{***}, datë 19.07.2012, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit dhe Xh. T., për automjetin me targë: {***}, rezulton se shtetasi Xh. T. e ka dhënë automjetin në përdorim të subjektit të rivlerësimit, për një periudhë kohe pa afat, pa kundërshtpërblim dhe me të drejtë përdorimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

⁵² (i) Çështje gjyqësore me paditës shoqërinë “{***}” SHPK, të paditur “{***}” ShA, me objekt: “Detyrimi i të paditurit t’i paguajë paditësit shumën prej 60.000 dollarë amerikanë dhe marrjen e masës për sigurimin e padisë, duke bllokuar anijen e të paditurit”, regjistruar më datë 23.03.2011. Me vendimin datë 01.12.2011, subjekti i rivlerësimit ka vendosur “pushimin e gjykimit” për shkak se paditësi nuk është paraqitur në seancë gjyqësore. (ii) Çështje gjyqësore me paditës A., L. e Y. K. dhe të paditur shoqërinë “{***}” SHPK, me objekt: “Detyrimin e të paditurit të dorëzojë pasuritë e përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes, të kryejë regjistrimin e tyre në regjistrat hipotekorë në emër të paditësve etj.”, regjistruar më datë 05.11.2014.

në gjykim çështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë e këtij shtetasi, vlerësoj se kjo situatë mund të konsiderohet se ka ndikuar në vendimmarrjet e subjektit.

7.1 Edhe pse vendimmarrjet e subjektit në këto raste, ku palë në gjykim ka qenë shoqëria e R. K., i vlerësoj në zbatim të drejtë të ligjit, gjykoj se këto rrethana e vendosin atë në kushtet e konfliktit në dukje të interesit, sipas nenit 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, për të cilat subjekti duhej të ishte treguar i kujdesshëm dhe t'i shmangte. Megjithatë, vlerësoj se vendimi i Kolegjit duhet të mbante në konsideratë edhe disa rrethana të tjera, që kanë të bëjnë me: (i) faktin që subjekti nuk e ka përfituar pronën nëpërmjet vendimit për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit dhënë prej tij, por ka qenë çështja gjyqësore e themelit, ajo që ka zgjidhur konfliktin gjyqësor midis pronarëve të truallit dhe shoqërisë “{***}” ShPK, pikërisht për godinën në të cilën ndodhej apartamenti i blerë nga subjekti i rivlerësimit; (ii) periudhën e gjatë të ushtrimit të detyrës nga magjistrati; (iii) faktin që ndaj tij nuk rezulton të ketë asnjë masë disiplinore; (iv) ngarkesën e punës në një gjykatë të një rrethi gjyqësor të madh, si dhe peshën që mund të marrin vetëm këto raste të konstatimit të konfliktit të interesit dhe pasojat e ardhura prej tyre.

7.2 Vetëm prania e këtyre rasteve të konstatuara si sjellje e subjektit në kushtet e konfliktit të interesit, kur në vlerësimin e aftësive profesionale subjekti nuk rezulton që të ketë dëshmuar haptazi në vazhdimësi gjykime të gabuara, me gabime thelbësore dhe serioze apo të ketë shfaqur problematika e mangësi në raport me indikatorët e kriterëve të vlerësimit⁵³, çmoj se pesha që marrin këto raste nuk duhet të konsiderohet në vlerësimin tërësor të të tria kriterëve sipas nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, dhe si një sjellje që cenon besimin e publikut te drejtësia, sipas nenit 61, pika 5 e këtij ligji.

8. *Lidhur me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.* Bazuar në vlerësimet e mësipërme, gjykoj se subjekti i rivlerësimit, me gjithë problematikën e konstatuara në të tria kriteret e rivlerësimit, të cilat për peshën që ato kanë në raport me një vlerësim të përgjithshëm të subjektit, nuk gjendet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Në vlerësimin tim, rrethanat që janë konstatuar nga Komisioni dhe në vendimin e Kolegjit, që lidhen me kriterin e kontrollit të pasurisë, atë të figurës dhe konfliktin e interesit, mbeten të tilla që nuk mund të afektojnë aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

8.1 Mendoj se në vendimin e Kolegjit nuk ka një arsyetim bindës për ta ngritur kualifikimin ligjor të rastit në vlerësimin tërësor të të tria kriterëve, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për të rezultuar me faktin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Këtë kualifikim ligjor e konsideroj të sforcuar, për sa kohë subjekti klasifikohet sipas nenit 61, pika 3, që përbën shkak shkarkimi për kriterin e figurës.

8.2 Rrethanat e analizuara në vendim për këtë kriter mendoj se janë të mjaftueshme për të qëndruar në mënyrë autonome si shkak shkarkimi, pa qenë e domosdoshme për një vlerësim të përgjithshëm sipas nenit 4, pika 2 e sipërcituar. Në këto kushte, në ndryshim nga arsyetimi i bërë në vendimin e Kolegjit, çmoj se rrethanat e mësipërme, të lidhura vetëm me kriterin e kontrollit të figurës, nuk mund të konsiderohen si elemente të mjaftueshme për të konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut në sistemin e drejtësisë, sipas parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

⁵³ Sipas indikatorëve të përcaktuar në nenet 74 dhe 76 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.